



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. (*Shqyrtimi nen për nen*).
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar””. (*Shqyrtimi nen për nen*).
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
5. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. (*Shqyrtimi nen për nen*).
6. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.
7. Projektvendimi për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Dashamir Peza, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Vangjel Tavo – deputet, propozues i projektligjit

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Milena Harito – ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Rovena Voda – këshilltare e Ministres për Marrëdhëniet me Parlamentin

Edlira Jorgaqi – drejtore e Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë

Katrin Treska - përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë

Illir Bejko – përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë

Pranvera Behushi - drejtore Juridike pranë Ministrisë së Brendshme

Enkelejd Lamaj - jurist i departamentit juridik të INUK-ut

Miran Kopani – këshilltar pranë Gjykatës së Lartë

Alma Kodraliu – këshilltare pranë Gjykatës së Lartë

Manjola Xhaxho – përfaqësuese e Gjykatës së Lartë

Artur Graham – përfaqësues i OSBE-së

Ama Kraja – përfaqësuese e OSBE-së

Albana Koçiu – drejtore e DAP-it

Jusilda Bocaj – këshilltare e Ministres për medien

Iris Petrela – përfaqësues i OSBE-së

Erjon Luci – zëvendësministër i Financave

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Besnik Dervishi – komisioner i Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Vilma Çausholli – përfaqësuese nga Ministria e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen për ditën e sotme, e cila sot ka një rend dite të ngjeshur për shkak edhe të faktit se do të duhet të përfundojnë një sërë projektesh për të cilat kemi kohë që diskutojmë dhe debatojmë, por ka ardhur momenti që, sipas detyrimit që kemi nga programi dhe kalendari i seancës, t'i paraqiten seancës plenare për shqyrtim.

Fillojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nismë e deputetit Vangjel Tavo.

Zoti Tavo, faleminderit! Dëshiroj që edhe sipas rregullit procedural të bëni një paraqitje të nismës suaj.

Vangjel Tavo – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, kjo nismë për një ndryshim në ligjin për ndarjen administrative, vjen edhe pas një kërkesë të të zgjedhurve vendorë të komunës së re të krijuar tashmë të Dropullit, të cilët u drejtohen deputetëve të qarkut të Gjirokastrës dhe kërkojnë pikërisht këtë ndryshim, kërkojnë që qendra e bashkisë së Dropullit të jetë fshati Jorgucat, duke e argumentuar këtë propozim si në aspektin gjeografik, si në aspektin historik, në aspektin e zhvillimit ekonomik, demografik dhe në aspektin e traditave dhe trashëgimisë kulturore.

Ky propozim, për sa i përket aspektit gjeografik, Jorgucati që propozohet si qendër e Dropullit është fshati që kufizon komunat aktuale të Dropullit të Poshtëm dhe të Dropullit të Sipërm dhe nga 40 fshatra që përbëhet tashmë bashkia e re e Dropullit, 2/3 e tyre dëshirojnë dhe kërkojnë që qendra e re të jetë Jorgucati.

Për sa i përket sipërfaqes, Dropulli i Sipërm është komuna me sipërfaqen më të madhe, por edhe me numër fshatrash më të mëdha ku nga 40 që janë, 18 prej tyre përbëhet Dropulli i Sipërm. Pra, edhe nga ana funksionale, fshati Jorgucat si qendër e bashkisë së Dropullit është më funksional, pasi lidh dy komunat Dropull i Poshtëm dhe ai i Sipërm, por edhe 5 fshatra, të cilat përfshihen në komunën e Dropullit të poshtëm, por quhen fshatrat e Rrëzës.

Në aspektin historik, Jorgucati ka qenë qendër administrative në periudhën para çlirimit, sidomos në periudhën e mbretit Zog, por edhe në periudhën e monizmit, Jorgucati ka qenë fshati ose zona ku kryheshin një sërë shërbimesh administrative dhe sociale.

Në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe social të zonës, Jorgucati është një nyje lidhëse midis pikës doganore të Kakavijës, bashkisë Gjirokastrë, bashkisë së re që krijohet nga bashkimi i komunave Mesopotan, Finiq, Livadhia, Aliko dhe Rivër, si dhe bashkisë Delvinë dhe Sarandë.

Dua të theksoj që në fshatin Jorgucat ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi 10 shoqëri private të tipit sh.p.k., një shkollë 9-vjeçare, hotel, 8 dyqane, minimarkete, taverna, restorante etj. Gjithashtu, veçori e Jorgucatit është se këtu janë funksionale poliklinika, si dhe qendra shëndetësore, një pikë policie që është në funksion të tri komunave që përbëjnë tashmë bashkinë e re të Dropullit.

Në aspektin demografik, Jorgucati është fshati i dytë më i madh në bashkinë e re që krijohet për sa i përket numrit të popullsisë, ndërsa komuna Dropull i Sipërm në të cilën përfshihet edhe Jorgucati është komuna më e madhe për sa i përket numrit të popullsisë në këtë bashki të re.

Së fundi, në aspektin e traditave dhe trashëgimisë kulturore, Jorgucati përbën qendrën e bashkimit të këtyre vlerave në të gjithë hapësirën e bashkisë së Dropullit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Tavo!

Kush ka pyetje, ju lutem?

Bashkim Fino – Kolegu Tavo si çdo koleg tjetër mund të bëjë propozime. Pyetja që kam unë është, a është marrë mendimi i qeverisë, se ka faturë financiare?

Fatmir Xhafaj – Nga ajo që shikoj unë këtu dhe nga sa lexoj nuk shikoj që të ketë vend për faturë financiare.

Faleminderit!

Dashamir Peza – Kush është kryeqendra e komunës së Dropullit të Sipërm? Është Vriseraja?

Vangjel Tavo – Qendra aktuale e komunës së Dropullit të Sipërm është fshati Vrisera.

Dashamir Peza – Kisha edhe një pyetje tjetër. Duke qenë se fshati Vrisera është sot bashki, nesër, nëse Jorgucati do të bëhet qendër e bashkisë, të themi, do të jenë zyrat e bashkisë, do të duhet të ndërtohen ambiente të reja për të sistemuar bashkinë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Tavo.

Vangjel Tavo – Ambientet e reja të bashkisë së re me qendër fshatin Jorgucat, nëse do të ndodhë pas këtij ndryshimi, janë parashikuar që të jenë në shkollën aktuale 9-vjeçare, e cila ka goxha ambient, ku kati i parë i saj të jetë shkollë siç është aktualisht funksionale dhe kati i dytë sot është i lirë dhe ka zyra dyfish ambientesh seç ka aktualisht qendra e komunës që është Vriseraja, por qendra e komunës së Dropullit të Poshtëm që është Sofratika.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Tavo.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera. Diskutime? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Duke përfituar nga rasti, pasi kam qenë bashkëkryetar i Komisionit të Reformës së ndarjes Territoriale, e cila u konsolidua dhe edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, unë mendoj që çdo deputet ka të drejtë të bëjë propozime dhe të sjell këtu mendime, sugjerime, pavarësisht se mund të organizojë edhe marrje mendimesh nga kryetarët aktualë, të cilët, për mendimin tim, kanë konflikt interesi, sepse janë në fund të mbarimit të mandatit për të ndryshuar qendrën e bashkisë së re. Të mos harrojmë një gjë dhe këtë e kam për ju, përfaqësues të Komisionit të Ligjeve, që nuk keni qenë pjesë e komisionit tonë, ku natyrisht ne kemi pasur kërkesa gjatë gjithë kohës, gjatë atyre muajve që kemi diskutuar për ndarjen e re territoriale, kërkesa të ndryshme edhe nga kryetarë të ndryshëm për të ndryshuar qendrat e bashkive.

Por natyrisht, nuk i jemi futur kësaj loje, sepse menduam të bënim ndarjen territoriale, duke mbajtur në parametra ato qytete kryesore dhe ato zyra ku është zhvilluar dhe ka ecur përpara bashkia. Në rastin konkret propozimi që na vjen sot, është bashkimi i 3 komunave Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni, të cilat realisht dhe historikisht i ka pasur Dropulli i Poshtëm, meqenëse unë dhe zoti Tavo jemi nga një zonë, nga Gjirokastra, kemi Sofratikën si kryeqendër, Grapshin në fillim pastaj Sofratikën.

Në këto momente komuna e Dropullit të Poshtëm qendër të saj ka Sofratikën, ashtu siç edhe komuna e Dropullit të Sipërm qendër e saj ka qenë Vriseraja. Unë mendoj që ne nuk kemi

bërë gjë tjetër veçse kur kemi bërë ndarjen territoriale, kemi menduar dhe kemi thënë që në kryeqendrën ku janë zyrat dhe ku është Sofratika të jetë edhe qendra e kësaj bashkie të re, e cila do të zhvillohet akoma edhe më shumë.

Unë mendoj që është një nga bashkitë e fuqishme që do të zhvillohet. Nga kjo pikëpamje kur e bëra pyetjen, zoti kryetar, a është marrë mendimi i qeverisë, kam parasysht pikërisht pyetjen që bëri zoti Peza. Fjala këtu është për të pasur ambiente të nevojshme për të kryer funksionet një bashki. Ne sot kemi dy palë zyra, dy godina, një në Vrisera dhe një në Sofratikë dhe natyrisht që ato nuk dalin jashtë mode, sepse ne shërbimet e çdo ish-komune do t'i vazhdojmë, duke i shfrytëzuar ato zyra, por të bëjmë një qendër të re, në një godinë të re qoftë edhe duke sakrifikuar gjysmën e shkollës, sepse, për mendimin tim, duhet bërë një godinë e re për të mbajtur këtë bashki nga e para, mua më duket një luks i tepërt dhe i madh. Prandaj e bëra pyetjen, që duhet marrë edhe mendimi i qeverisë. Nga ana tjetër do të ishte mirë që ky propozim që na vjen sot është pak i vonuar në sensin, kur ne kemi jo më pak se 2-3 muaj që kemi mbarur reformën territoriale.

Mbaruam reformën territoriale, ku bëmë një përshkrim të gjerë të kësaj situate, pyetëm dhe morëm mendime, siç thotë ligji dhe Kushtetuta, nuk na është shprehur asnjëra nga këto njësi vendore që duan ta ndryshojnë qendrën e bashkisë. Zoti Tavo është deputet i vjetër, por ai nuk e bëri një kërkesë të tillë në momentin dhe në kohën e duhur, mbase pa e paragjykuar zotin Tavo, ndoshta e kishte menduar se nuk do të miratohej reforma territoriale edhe për shkak të votës që ai ka dhënë, abstenim. Pra, duke e menduar këtë, ai ka thënë që nuk po e kërkoj qendrën e re të Jorgucatit dhe në momentet që kjo është bërë vepër dhe është miratuar, na kërkon të bëjmë ndryshimin e një qendre. Unë mendoj që kjo mund të shihet në këtë mënyrë, që çdo deputet dhe çdo njeri që na bën nga një kërkesë pas një muaji, dy muajsh ne të rrimë e të merremi përherë me ndarjen e re territoriale.

Kjo çështje është bërë, do të kalojë njëfarë kohe do të konsolidohet, natyrisht që mund të ketë edhe korrigjimet e nevojshme edhe më vonë, nuk jam unë ai që mund të them që nuk do të ketë asnjëherë, por sa e mbaruam, ndërkohë do të jetë funksionale më 21 qershor, kur të bëhen zgjedhjet e vitit të ardhshëm, siç e ka dekretuar edhe Presidenti dhe të ndryshojmë qendrat e qendrave të bashkive, mua më duket jo korrekte dhe jo e ndershme në rastin konkret.

Mendoj që t'ia lëmë kohës më mirë, t'ua lëmë banorëve, të dalë zgjedhja e bashkisë së re, ku vetë banorët atje, kryetari i ri, këshilli i ri, të bëjnë kërkesën përkatëse në qoftë se ajo do të jetë e domosdoshme siç janë këtu argumentet, të cilat i ka sjell kolegu Tavo, ne këtu jemi dhe mund ta rishohim nga fundi i vitit tjetër.

Në këto momente mua më duket jooportune për të marrë dhe për të diskutuar ndarje të re territoriale, thjesht për të vënë një qendër fshati. Nuk dua të paragjykoj as përkatësinë se nga është zoti Tavo, por kjo nuk bëhet në këtë mënyrë, por në një mënyrë serioze me studim, duke marrë mendime, duke sugjeruar në kohën dhe në momentin e duhur. Nuk mund të bëhet një ndarje e re territoriale pasi kanë kaluar dy muaj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Vasili, e ka kërkuar fjalën.

Petrit Vasili – E mora fjalën jo thjesht dhe vetëm si anëtar i Komisionit të Ligjeve, por sigurisht edhe si anëtar i Komisionit të Reformës Territoriale. Unë që në krye të herës do të përpiqem të ndaj qëndrimin për të ecur në zgjidhjen e një çështjeje të caktuar dhe do ta zhvesh këtë nga çdo lloj qëndrimi i karakterit emocional, sepse kjo nuk na ndihmon për të shkuar përpara.

Ne kemi qenë dhe kemi funksionuar në të gjithë problematikën shumë të komplikuar të ndarjes së re territoriale, në rrugën e një mirëkuptimi dhe një mendjehapje, e cila na bëri të mundur që ne ta kishim një reformë të tillë, pra një reformë të konsoliduar edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke mbyllur kështu një cikël diskutimesh për këtë çështje.

Mendoj se problemi që shtrohet është shumë i thjeshtë, më se minimalist. Absolutisht që jam i bindur dhe nuk do t'i futem diskutimit për reflektimin që reforma territoriale do të ketë edhe në infrastrukturën që duhet për bashkitë përkatëse, sepse po t'i futemi këtij diskutimi, ky është një diskutim që shkon tutje, ecën larg dhe mund të ishte një shkak për të ndërprerë fare edhe ecjen përpara të reformës territoriale. Ne nuk kemi vepruar në asnjë rast në mënyrë të tillë, sepse kemi marrë vendime për çështje që ishin shumë të larmishme, të cilat në momente të caktuara hynin në konflikt edhe me kriteret, megjithatë, ka ecur zemërgjerësia dhe besoj që në këtë mënyrë, duhet të ecim edhe në këtë rast.

Problemi që kemi sot në tavolinë është një problem shumë i vogël në raport me reformën e madhe që kemi bërë dhe nuk duhet të na shpenzonte as kohë, as energji dhe as nerva, sepse jemi shumë larg asaj që është bërë në raport me një korrektim apo një korrigjim. Duhet të pranojmë që ne kemi pasur një kompromis të brendshëm jashtë kritereve dhe ky ka qenë një qëndrim politik, ku ne kemi qenë për të ndërtuar, për të ngritur edhe bashki minoritare. E vërteta është që zoti Fino ka qenë dakord që të ngrihet, ndërsa unë nuk kam qenë dakord dhe në këtë pikë, unë e kërkoj me dashamirësi edhe mbështetjen e zotit Fino, se meqenëse unë pranova një zgjidhje të tillë, e cila ishte maksimaliste dhe sot them që kanë qenë më mendjehapur këta sesa unë, pra ta pranoni, tani në 3 komuna minoritare kur një pjesë e mirë e tyre në realitet njihen. Mendimi që shpreh zoti Tavo është një mendim i mbështetur edhe nga zoti Dule, i cili ka qenë një nga mbështetësit e mëdhenj për këtë çështje dhe ne pikërisht mbi këto logjika ngritëm dhe pranuar bashkekzistencën e njësive administrative të ngritura me kritere të caktuara, me njësi administrative, të cilat këto kritere nuk i respektojmë siç duhet. Për këtë kemi bërë një kompromis të madh politik dhe unë them që kemi bërë shumë mirë që e kemi bërë. Sot në realitetet historike se si kanë lëvizur ndër vite nuk mund të jenë penguese për të bërë një përcaktim më të mirë, siç është në rastin konkret, ku Jorgucati dihet historikisht që në zonë të madhe ka qenë kryeqendër. A erdhëm më tutje dhe ngritëm ne në kohët e mëpasme disa komuna në vend të një realiteti të madh dhe të përqendruar, shumë mirë kanë bërë, se në kohë të ndryshme janë ngritur komuna të ndryshme, pasi kanë ngritur edhe kryeqendra komunash të ndryshme. Sot këto komunitete të organizuara për disa arsye historike, linguistike etj., u organizuan në një realitet të ri dhe gjenden më mirë me këtë organizim, i cili është edhe në pikëpamje të kollajllëkut të lëvizjes si shërbime etj., dhe është më pozitiv, pse duhet të shpenzojmë kaq shumë energji për këtë çështje.

Unë mendoj që absolutisht asnjë gjë nuk i lëviz reformës tonë nga një korrektim i tillë, pasi ky korrektim në kohën që ne hartonim procesin, nuk do të na kishte marrë më shumë se 2 minuta, por ka mundësi ta ndreqim dhe të bëjmë ndonjë gjë më mirë. Ç'na gjeti? Nuk kemi hezituuar të bëjmë bashki supergjigande, ku mua nuk më ka dhënë dikush përgjigje edhe sot e kësaj dite pse i bëmë aq të mëdha. Kam ngritur me dashamirësi dhe qetësi dorën, dhe mirë kam bërë, për gjëra për të cilat unë ende kam vërejtjet e mia dhe ruaj rezervat për këtë çështje.

Prandaj mendoj se nuk mund ta bëjmë një çështje kaq të madhe, një çështje e cila është minimalisht e vogël, por bëjmë thjesht një korrigtim që i shkon më mirë atij realiteti dhe jam dakord plotësisht me kolegun Fino, i cili thotë, se koha do ta tregojë. Koha do ta tregojë që edhe këtë korrigjim që po bëjmë do i qëndroj apo jo, por koha nuk mund të jetë një shkak që të na pengojë që të bëjmë një korrigjim të caktuar, i cili është minimalist, nuk i thotë dhe nuk i lëviz asnjë presje reformës tonë. Reforma jonë ka pasur vetëm një sens, do të kemi bashki minoritare? Po i kemi. Ky ishte vendimi i madh dhe këtë e kemi marrë. Është më komode në kontekstin historik dhe gjeografik Jorgucati nga Vriseraja, kjo është diçka që ai komunitet atje gjendet më mirë me këtë gjë. Diçka është e vërtetë, meqenëse e kemi pasur kriter dhe zhvillim historik, dihet që Jorgucati ka qenë atje. Unë nuk jam as minoritar, as kam qenë ndonjëherë deputet i Gjirokastrës, por them që në këtë rast, kjo zgjidhje na vë në një komfort të gjithëve, na bën që të jemi gjakftohtë për të korrigjuar edhe gjëra të vogla, të cilat absolutisht, nuk janë asgjë.

Të bësh kryeqendër Jorgucatin, ndërkohë që kemi bashkinë e Tiranës që është sa gjysma e Shqipërisë dhe nuk kemi hezituar dhe kemi marrë një vendim kaq të fortë dhe shumë e shumë shembuj të tjerë, kjo ka ecur me mirëkuptim për t'i hapur rrugën një gjëje kaq të madhe, pasi ndarja administrative e Shqipërisë ishte revolucion. Besoj se ishte një reformë, e cila do të shënjoj të gjitha gjërat e mëdha që ka bërë dhe do të bëjë kjo mazhorancë dhe nuk do t'ia kalojë asnjë kësaj mazhorance. Pra, të kursejmë kohën dhe energjinë dhe të ecim përpara për një gjë të tillë, pasi unë mendoj që kemi shkallën e duhur të mirëkuptimit për të mos ta ngritur më shumë këtë çështje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Lutaj.

Piro Lutaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të gjithë ne dje, ne që e kemi dëshiruar edhe kolegët tanë që kanë kontribuar për këtë reformë jetike për Shqipërinë, përfundimisht morëm përgjigjen edhe nga një institucion i rëndësishëm, siç është Gjykata Kushtetuese dhe të them të vërtetën nuk e kisha menduar që ende pa lindur “bebja”, do të fillonim edhe të ndërhyjmë në një reformë kaq të madhe jetike.

Unë i dëgjova edhe argumentet që dha kolegu ynë Tavo, pasi ai sigurisht që e njeh mirë rajonin, sensibilitetet dhe unë e vlerësoj ndërhyrjen e tij, por, me sa di, ka pasur problematika të tilla të mëdha gjatë diskutimit që është bërë në periudhën e diskutimit të reformës. Ne kemi fatin

se jemi komision i rëndësishëm në Kuvendin e Shqipërisë dhe këtu kemi anëtarët e Komisionit për Reformën Territoriale, kemi bashkëkryetarin, zotin Fino, dhe të them të vërtetën argumentet që dha zoti Fino shkojnë më shumë në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajmë për këtë propozim.

Mendoj se duhet të krijojmë një precedent. Komunitete të ndryshme, deputetë të ndryshëm mund të kërkojnë iniciativa të tilla, por mendoj se nuk do t'i përkonin interesit që kemi për reformën e mirëpritur dhe të shumëdëshiruar nga të gjithë shqiptarët dhe të përgatitemi për të shkuar në zgjedhjet e datës 21 qershor.

Megjithatë në raport me qëndrimin dhe me argumentet që do të japin kolegët, do të jap edhe qëndrimin tim për këtë gjë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Lutaj!

Zoti Peza, urdhëroni!

Dashamir Peza – Faleminderit zoti Xhafaj!

Unë nuk do të zgjatem shumë. Jam plotësisht dakord që jemi në periudhë Krishtlindjesh, në periudhë dhuratash në kuptim dashamirësie midis njëri-tjetrit dhe personalisht dua të jetoj me shpirtin e dhuratave, por në rastin konkret, mendoj se kjo iniciativë ose është shumë herët, ose është shumë vonë. Pse është? Është shumë vonë, sepse gjatë periudhës që u bë Komisioni i Reformës Zgjedhore, duhet të ishte bërë, ose është shumë shpejt, pikërisht një ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Propozimi i zotit Fino që pasi të konstituohet bashkia e re, mendoj se është rruga e drejtë dhe e arsyeshme për t'iu përafuar këtij problemi.

Unë besoj se edhe zoti Tavo do ta mirëkuptojë këtë gjë, jo thjesht formalisht, por realisht. Përmasat e asaj që kemi arritur me Reformën Zgjedhore janë aq të mëdha, saqë për një gjë kaq të vogël mendoj se është e panevojshme të ndërhyjmë në atë që ka qenë produkt i një pune të shkëlqyer të të gjithë grupit të Reformës Zgjedhore, sepse do të hapnim precedentë të panevojshëm, do të hapnim dëshira dhe orekse për të ndryshuar dhe për ta futur në vazhden e një zinxhiri i cili nuk i dihet se ku i del fundi.

Unë personalisht e gjej të papërshtatshëm në kohë këtë propozim dhe mendoj se zgjidhja e arsyeshme dhe mirëkuptuese midis ne të gjithëve është që këtë çështje ta lëmë pas zgjedhjeve lokale.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili - E mora fjalën, sepse pashë që citimet ishin të njëanshme nga ana e kolegëve dhe kjo nuk më duket as korrekte, as dashamirëse.

Ky nuk ka qenë dhe nuk ka për të qenë asnjëherë vendim i madh. Ju lutem, shumë, mos na ulni nivelin në këtë nivel minimalist, duke thënë se kjo është gjëja që tund reformën, kjo është gjëja që lëviz reformën, kjo është gjëja që krijon orekse. Orekset dhe të gjitha gjërat kanë mbaruar që ditën që ne kemi vendosur 61 njësi vendore.

Çështja e madhe parimore, po e përsëris ta dëgjojnë edhe kolegët, ka qenë të bëjmë bashki minoritare ose jo. Ky është problem shumë i madh filozofik, politik e si të doni ju.

Unë kam qenë njëri nga ata që nuk kam qenë dakord. Këtë e kam bërë publike. E di edhe zoti Fino, e dinë të gjithë. Më dhanë disa argumente (i pranova, nuk i pranova), i pranoi dashamirësia dhe mirëkuptimi, gjë që po kërkoj unë në këtë tavolinë. Po ua kërkoj edhe kolegëve që përpara se të ngecim te një argument apo detaj, hajde të ngrihemi në nivel dhe të flasim. Kemi marrë një vendim të madh që t'u themi minoritarëve jetoni të organizuar në një mënyrë të tillë. Ky është vendim që në atë kohë kishte probleme edhe me raportet si trajtoheshin minoritetet, përthithja e tyre brenda komuniteteve të mëdha etj., etj. Pra ishte një diskutim shumë i vështirë. Mënyra se si e zgjidhëm, ndoshta edhe joparimore, ishte e shëndetshme për disa gjëra të tjera.

E pra, kur erdhët në këtë mënyrë dhe minoritarët organizuan realitetin e tyre, ky oreks maksimal, meqenëse u fol për orekset, është i zgjidhur dhe e ka atje. Çfarë ka mbetur? Ka mbetur te saktësimi atje ku ka qenë për 70-80 vjet, jetë e mot. Hajde të bëjmë një korrektim, që nuk i lëviz, po e them përsëri, asgjë reformës. Reformës i lëvizin njësitë e mëdha. Çfarë madhësie kanë? Si do të futen në zgjedhje? Po cila është kryeqendra që i bëri masë të shkurtër korrenti, u dogjën zyrat e komunës dhe nuk do të bëjmë zgjedhje?

Prandaj për të qenë përtej subjektivizmave të vogla, personalisht jam ngritur mbi to në të gjitha zgjidhjet dhe momentet e mëdha kur është dashur të marrë një vendim maxhoranca, përfshirë edhe reformën territoriale. Kam pasur edhe rezervat e mia, jo të vogla, për çështje të caktuara. Kam bërë edhe pyetje, për të cilat nuk kam marrë as përgjigjet e duhura. Megjithatë ka prevaluar dashamirësia. Kështu që po e them shqip, argumentet e mëdha për çfarë është bërë, janë këto. Ky është korrektim. Ky nuk hyn as në nivelin e lapsusit për atë realitet që është krijuar atje. Nëse doni të mbajmë qëndrime të tjera, i mbajmë. Unë nuk kam shqetësim, flas si anëtar i Komisionit të Reformës Territoriale, por në të gjitha çështjet e mëdha, zoti Fino është dëshmitar dhe e di shumë mirë që ka prevaluar mirëkuptimi dhe vizioni që të bëjmë një gjë të madhe.

Kurse ngecja për këtë gjë dhe fryrja e kësaj gjëje nuk na çon gjëkund dhe pikërisht një ditë pas kësaj, që thoni ju, reformë kushtetuese, dhe që na dhatë të drejtë për mirëkuptimet dhe dashamirësinë e njëri-tjetrit do të thotë që ajo dashamirësi që na solli në këtë rezultat të madh, nuk mund të mungojë në këtë rast dhe të na bëjë të ngecim te ndonjë problem i vogël. Kjo ishte ajo për të cilën desha të tërhiqja vëmendjen e kolegëve në kuptimin më pozitiv të fjalës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ka diskutime të tjera?

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Diskutimi i parë i zotit Vasili më turbulloi edhe mua mendjen, ishte vërtet shumë impresionuese, sepse tha zhvishu nga emocionet etj., me radhë. Diskutimi i dytë më dha më shumë emocione dhe mbeta në gjendjen e mëparshme.

Fatmir Xhafaj – Ne kemi vetëm një fat që, kur kemi bërë reformën e madhe, e kemi bërë pa emocione, me qartësi, me pjekuri dhe me përgjegjshmëri. Kjo na gëzon të gjithëve. Emocionet e tjera për gjëra të vogla dhe emocione të vogla lejohen gjithmonë.

E rëndësishme ishte që i dhatë një fytyrë të re vendit me reformën, që e keni bërë pa emocione, me qartësi, me kthjelltësi dhe me shumë pjekuri. Kjo është e rëndësishme.

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? 2. Abstenim? 2.

Miratohet në parim.

Kalojmë nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? 2. Abstenim? 2.

Miratohet edhe në tërësi.

Këtu mbyllet edhe kjo pikë.

Falënderoj zotin Tavo, si dhe të gjithë kolegët deputetë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. (*Shqyrtimi i nen për nen.*)

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Dashamir Peza, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Ermonela Felaj – ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Rovena Voda – këshilltare e ministres për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Katrin Treska – drejtoreshë në Ministrinë e Drejtësisë.

Pranvera Behushi - drejtoreshë juridike në Ministrinë e Brendshme.

Albana Koçiu – drejtoreshë e DAP-it.

Enkelejd Lamaj – jurist në departamentin juridik në INUK.

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë, 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””.

Kemi votuar në parim dhe sot do të vazhdojmë diskutimin nen për nen.

Zonja Ministre, mirëdita!

Ju lutem, relatorët të ndjekin.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nenin 2, që është edhe thelbi i ligjit.

Ulsi Manja – Për nenin 2 propozojmë: “Ndërtimi i kryer pa leje në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën, në pronësinë e vet dënohet me burgim deri në një vit.”

Pra, këtu kemi hequr termin “punim” dhe termin “për qëllime fitimi”. Te shkelja kemi cilësuar “shkeljen e rëndë”. Po kështu kemi futur fjalën “në pronësi”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Deri në një vit?

Ulsi Manja – Po. Po kjo vepër e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet. Kemi shtuar një paragraf të tretë: “Po kjo vepër kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga 3 deri në 8 vjet”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ky është propozimi juaj që keni konsultuar. Kam përshtypjen se ky propozim shkon në të njëjtën linjë me propozimin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe me komentet që janë bërë nga EURALIUS-i.

Zonja Ministre, besoj se edhe ju jeni dakord me sugjerimin e kolegëve?

Ermonela Felaj - Le t'i marrim paragrafët me radhë që të shprehim edhe ne argumentet tona.

Në paragrafin e parë: “**cenimi 199/a**, ndërtimi i paligjshëm”, propozohet të hiqet termi “punim i kryer pa leje”. Sikurse e sqaruam edhe dje, ne e kemi futur këtë fjalë për faktin e thjeshtë që në ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin” specifikohet që jo vetëm të merret leje për ndërtimet, por edhe për punimet duhet të merret leje. Dhe nga kategoria e gjerë e të gjitha punimeve janë vetëm një pjesë e vogël punimesh, ose ato punime, që përcaktohen në rregulloren

e zhvillimit për të cilat nuk merret leje. Për ne kjo është shumë e rëndësishme, sepse fjala vjen, ti mund të gërmosh në themelet e pallatit për të bërë një magazinë aty dhe rrezikon jetën e të gjithëve. Sikurse mund të prishësh, dhe të prishësh është të bësh një punim dhe të prishësh rrugën ndërkohë, të prishësh linjat telefonike, linjën e internetit dhe të rrezikosh jetën e njerëzve.

Kështu që përderisa ligji e ka njësuar termin “ndërtim dhe punim” dhe përderisa ka dhe punime për të cilat duhet dhënë leje dhe praktika ka treguar që edhe punimet njësoj, si dhe ndërtimet bëhen dhe cenojnë interesin publik, cenojnë hapësirat publike, atëherë ato duhet të penalizohen njësoj dhe nuk kemi pse të ruajmë diferenca në këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kur është dashur dhe për ato që është dashur, ligjvënësi e ka parashikuar edhe termin “punim”, por në këtë rast ligjvënësi mund të mendojë që të mos e ngrejë nën nivelin e përgjegjësisë penale. Nuk është ndonjë qamet i madh. Më duket e arsyeshme.

Keni gjë tjetër për të thënë?

Ermonela Felaj – Për sa i takon shtimit, në paragrafin e parë, të fjalëve “dhe në pronësi në tokë të vet”, ne nuk kemi ndërhyrë në këtë pjesë, nuk e kemi sjellë si ndryshim. Për ne ligji ka qenë i qartë. Fakti që askush në këto vite, nga 2008-ta deri në 2014-n nuk ka bërë objeksion në asnjë lloj gjykate për moskuptimin apo keqkuptimin e termit “në tokë të vet”, besoj se është më se i tregueshëm.

Sidoqoftë ky është në vullnetin tuaj. Për ne nuk krijon ndonjë shqetësim. Ndërkohë përdorimi “realisht” krijon shqetësim.

Për sa i takon paragrafit të dytë, propozohet të hiqet termi “për qëllime fitimi” dhe të përdoret një term tjetër “pasoja e rëndë”. Unë do të thosha që termi “për qëllime fitimi”, që është motivi i kryerjes së veprës penale, nuk është një term që e shpikëm ne, por është një term të cilin e gjejmë pothuajse në shumicën dërrmuese të neneve të Kodit Penal dhe në ndryshim nga termi “pasoja e rënda”, që edhe ai është një term i përdorur në Kodin Penal, termi “për qëllime fitimi” nuk është një term subjektiv në përcaktim.

Ndërkohë që “pasoja e rënda” ka qenë dhe mbetet subjektiv, që do të thotë që kur ka qenë fjala për pasojat e rënda në kuptimin monetar, i është dashur Gjykatës së Lartë të ndërhyrjes me vendim unifikues për të thënë cila quhet pasojë e rëndë dhe rast pas rasti, sipas natyrës së veprës, kjo është lënë në diskrecionin e të tretëve. Ndërkohë që ne mendojmë që “për

qëllime fitimi” ndan saktësisht ndërtimet që bëhen për t’u strehuar për nevoja thelbësisht vetjake nga ndërtimet që bëhen për të shfrytëzuar për aktivitet tregtar për t’ua shitur të tretëve etj., me radhë.

Është edhe një shqetësim qytetar, për hir të së vërtetës, të cilin ne nuk mund të themi që nuk e dëgjojmë. Në jo pak raste ne dëgjojmë qytetarë të ndryshëm që thonë: “Prishi shtëpinë, por nuk prishi pallatin”, ose prishi shtëpinë, por nuk prishi njësinë tregtare!”. Kështu që mendoj se ky term na ndihmon më mirë për ta bërë diferencën midis një ndërtimi të thjeshtë dhe një ndërtimi që për shkak edhe të volumeve se kur ndërton për këtë lloj qëllimi, sigurisht që volumet janë të ndryshme, edhe pasojat natyrisht janë shumë herë më të rënda në aspektin ekonomik.

Çfarë duhet të bëjë shteti për ta zhvendosur këtë ndërtim ose në rastin më të keq kur ai është legalizuar? Duhet ta shpronësojë shteti dhe vlerat pastaj shkojnë maksimale. Kështu që për oportunitet unë them që “për qëllime fitimi” është term i duhur.

I kam lexuar me vëmendje edhe vërejtjet që kanë ardhur nga prokurori i Përgjithshëm, nga EURALIUS-i dhe nga Konferenca Gjyqësore. Konferenca Gjyqësore ka thënë se është dakord me përmbajtjen e nenit në parim. EURALIUS-i ka bërë një ndryshim në atë që ne kuptojmë nuk ka thënë “për qëllime fitimi”, por ka thënë diçka të tillë “për qëllime për përfitim” që për mua nuk përbën sens.

Ndërkohë, argumenti për Prokurorinë e Përgjithshme, që ka përdorur argumentet “pasojat e rënda”, është i njëjti. Sidoqoftë, zgjidheni ju. Në qoftë se ne do ta lëmë te pasojat, të jeni të sigurt që këtë ua kemi lënë të tretëve dhe nuk kemi vendosur ne të jemi të qartë me ligjin.

Ndërkohë, këtu është hequr plotësisht dispozita e tretë që bën fjalë për rastin e dënimit të të gjithë zinxhirit të personave, që ekzekutojnë një punim apo një ndërtim pa leje.

Më duhet t’ju them, jo në emrin tim personal, por në emër të Këshillit të Ministrave, që ky është një qëndrim parimor që ne mbajmë. Ne duam të dënojmë të gjithë ata që bëjnë të mundur ekzekutimin e një ndërtimi pa leje. Dikush që ngarkon kamionin me llaç, me tulla, me beton, apo ku di unë se çfarë, dhe shkon atje duke ditur qartësisht se po ndodh një ndërtim në shkelje të ligjit, natyrisht që meriton të dënohet.

Nga ana tjetër, kjo nuk është e re. Nëse do të shikojmë legjislacionin italian dhe francez, të gjithë grupin e këtyre njerëzve, që nuk e identifikojmë ne si të tillë, por e identifikon edhe ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52 të këtij ligji thuhet: “Pronari

i ndërtimit, sipërmarrësit, mbikëqyrësit, zbatuesi i punimeve përgjigjen solidarisht për shkeljet në ndërtim”, nuk e përjashton faktin që t’i përgjigjesh civilisht, nuk të përjashton absolutisht nga të përgjigjurit edhe penalisht në rastin konkret.

Për sa i takon diskutimit se si do t’i përcaktojmë ne këta ose çfarë nënkupton fjala “rast pas rasti”, fjala “rast pas rasti” nënkupton praktikën, kazusin që mund të ndodhë, që përfituesi i ndërtimit të identifikohet me pronarin. Pra, të jetë i njëjti person, por mund të jenë edhe të ndryshëm. Dikush jashtë vendit mund të dërgojë një sasi të hollash që t’i të ngresh një objekt në mënyrë të paligjshme e kështu me radhë, sipërmarrësi mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve. Nuk bëhet fjalë aspak për punëtorë. Në të gjithë këtë aksion që po bëjmë, si për rastin e vjedhjes së energjisë elektrike, edhe për rastin e prishjes së ndërtimeve pa leje, nuk duam të japim asnjë lloj shenjë tërheqjeje, asnjë lloj shenjë dobësie, sepse në momentin që do ta bëjmë këtë, në momentin që do të përkulemi, e gjithë situata në terren do të degradojë. Në fakt kemi arritur në pikën që nuk mundet më të tolerohet, sepse janë hapësira të tëra publike që janë zënë në mënyrë të dhunshme. Situata që kemi në Shqipëri është e pakrahasueshme me vendet e tjera të rajonit. Kështu që këto ndryshime që ne po bëjmë, po i bëjmë për shkak të situatës që realisht na godet fort në sy sa herë që na jepet mundësia të dalim si të gjithë qytetarët e tjerë dhe të shikojmë çfarë ndodh në rrugët dhe sheshet e Shqipërisë.

Dhe diçka tjetër, këtë e kam mes nesh si juristë, në paragrafin e dytë sipas propozimit të relatorit, propozohet një dënim 1-5 vjet, ndërsa për paragrafin e tretë, që çmohet si më i rëndë, propozohet një dënim 3-8 vjet. Unë mendoj se nuk është mekanizmi i duhur i zgjedhjes së masës së dënimit, sepse mund të ndodhë që duke lënë një dënim nga 1-5 vjet, dikush për diçka më të lehtë të dënohet, fjala vjen, 3 vjet ashtu siç dënohet dikush edhe për një vepër më të rëndë 3 vjet. Ndërkohë për masat e dënimit ne kemi zgjedhur në paragrafin e parë të hiqet mundësia e dënimit me gjobë dhe kjo vepër dënohet me burgim, dhe për paragrafin e dytë kemi zgjedhur një masë dënimi, por këtu mundet sigurisht edhe të vendosim ndryshe, 2-8 vjet që lejon që në rastin kur ti ndërton në tokën publike, në tokën shtetërore, në tokën e tjetrit apo ndërton për qëllime fitimi, sepse këto janë të gjitha të veçanta, ti dënohesh me një masë të tillë dënimi nga gjykimi me një treshe gjyqtarësh dhe jo me një gjyqtar të vetëm. Arsyeja është praktike; një gjyqtar i vetëm mund të manipulohet shumë më lehtë sesa tre gjyqtarë.

Kështu që për ta minimizuar edhe këtë ndodhi negative ne propozojmë këtë masë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Duke çmuar edhe gjykimin tuaj, edhe propozimin relatorit, kush ka komente nga kolegët?

Po, zoti Subashi.

Armando Subashi – Unë kam një propozim me shpresën se mund të gjejmë një të mesme midis propozimit që ka ardhur dhe propozimit të bërë nga relatori.

Në parim unë jam dakord me strukturën e nenit që propozoi relatori me tre paragrafë. Te paragrafi i fundit, nëse shtojmë edhe shprehjen “për qëllime fitimi”, besoj se e kemi zgjidhur edhe merakun që ka ministrja. Pra, paragrafi i tretë na jepet pastaj me dy raste. Rasti i parë ishte ai që tha relatori kur ka ardhur një pasojë e rëndë ose kur është bërë për qëllime fitimi dhe dënimi është ai që është. Këtu bëjmë edhe një diferencim midis dy momenteve, pra ndërtimi në tokën e tjetrit i një banese për nevoja vetjake, që mund të ketë dënimin që u propozua 1-5 vjet, dhe ndërtimi në tokën publike për qëllime fitimi që ka brenda një rrethanë të cilësuar që mund të bëjë rritjen e masës së dënimit që është nga 2-8 vjet. Paragrafi i tretë me dy rrethana cilësuese, pra duke pasur parasysh “pasojën e rëndë” ose “fillimin e fitimit brenda” e plotëson të gjithë merakun që kemi dhe bën një përshkallëzim të dispozitës në këto tri mundësi.

Për sa i përket dispozitës që është hequr dhe që lidhet me subjektet, pronarin, sipërmarrësin, mbikëqyrësin, sigurisht që nëse këto nuk parashikohen në dispozitë, mendoj se prokuroria nuk ka asnjë pengesë që në rast se konstaton që ndërtimi është i strukturuar në një mënyrë të tillë që aty ka edhe një sipërmarrës kundrejt një kontrate të lidhur, ose të kryer me veprime faktike në terren, nëse ka një zbatues punimesh, nëse ka një mbikëqyrës besoj se prokuroria nuk ka asnjë pengesë edhe duke mos e parashikuar ne që të gjithë këta persona t’i akuzojë në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me ndërtuesin. Pra në parimet e përgjithshme të së drejtës penale të gjithë këta mund të akuzohen në bashkëpunim sipas paragrafit përkatës. Nëse është duke u bërë një ndërtim në tokën e vet pa leje, sigurisht do ta akuzojmë për atë paragraf. Nëse është duke bërë një ndërtim publik në një tokë publike pa leje do të akuzohet, nëse është paragrafi i tretë përsëri do të akuzohet në bazë të nenit 25 të Kodit Penal. Kështu mund të zgjidhet. Dhe ky debat që bëme sot në komision shërben për mënyrën e të kuptuarit dhe zbatuarit të normës nëse, pasi të hyjë në fuqi nga prokuroritë gjykatat e kështu me radhë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka nga ndonjë gjë tjetër nga kolegët?

Ulsi Manja – Në parim unë jam dakord me këtë ndryshim ligjor të Kodit Penal, por edhe dje në prezantimin e nismës, vetë ministrja tha se biem dakord si kolegë që kjo është një dispozitë e bardhë dhe nuk mund të pretendohet se të gjitha do të jenë në dispozitën që propozohet, por do të ketë referencë në ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Unë mendoj që ligji nr. 107 i vitit 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, që ne e kemi u jep përgjigjen e duhur ligjore dhe adekuate të gjitha shqetësimeve. Konkretisht, në nenin 39 parashikohet se për cilat raste kërkohet leja e ndërtimit. Termi “punim” është përfshirë në atë që thonë teknikienët, punimet futen në kategorinë e restaurimeve dhe instalimeve. Pra, për punime themelore, ndërsa për punime për të cilat nuk kërkohet leja e ndërtimit e ka zgjidhur po neni 41 i ligjit kundrejt një deklarate paraprake. Por të mos harrojmë se po ky ligj shkeljet e një karakteri të lehtë i ka lënë në suazën e kundërvajtjeve administrative dhe i ndëshkon me gjobë.

Subjektet e kësaj vepre penale nuk mund të jepen në një dispozitë të posaçme të Kodit Penal në mënyrë shteruese, sepse po të shohim nenin 39 të ligjit dhe formulimi që sjell lihet jashtë ndëshkimit përfituesi i lejes së ndërtimit, pr, subjektet duhet të gjykohen rast pas rasti nga organi i prokurorisë. Aq më tepër që zoti Subashi tha që të ndëshkohen në bashkëpunim kur zinxhiri i përgjegjësisë penale është në bashkëpunim, por të mos harrojmë se në rastin e subjekteve që operojnë në fushën e ndërtimit Kodi Penal parashikon edhe përgjegjësinë penale të personave juridikë. Kështu që mua më duket se shqetësimi që keni merr përgjigjen në mënyrën se si relatori e ka formuluar dispozitën. Çështja e masave të dënimit pastaj është çështje që mund të diskutohet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kemi një propozim të relatorit, kemi një propozim tuajin, kemi ndryshimin, që me sa pashë unë, edhe relatorët bien dakord me ndërhyrjen e zotit Subashi. Keni ndonjë koment?

Po, zonja Ministre.

Ermonela Felaj - Për të qenë racionalë, ne kemi njësuar dënimin e ndërtuarit pa leje në tokë publike, në tokë shtetërore, në tokë të tjetrit dhe për qëllime fitimi. Për qëllime fitimi shkon veçmas, sepse në qoftë se ligjvënësi ka vendosur që të ndajë si më të rëndë aktualisht ndërtimin në tokë shtetërore, të tjetrit apo në tokë publike, ta dënojë më shumë sesa ti që ndërton në tokën tënde, natyrisht ka një logjikë të caktuar, sepse është më flagrante që të ndërtosh te toka

e tjetrit apo në atë që nuk është fare as e tjetrit, por është e të gjithëve. Në këtë logjikë edhe të ndërtosh për qëllime fitimi, qoftë në tokën tënde, qoftë dhe në regjimet e tjera të tokës është e rëndë. Ndërkohë që më duhet t'ju them se ne kemi pasur dhe kemi një vullnet të qartë për ta mbajtur siç është paragrafin e tretë të nenit 199, germa “a”. Nuk kemi pasur asnjë dyshim midis nesh për ta pasur këtë nen. Ne e dimë shumë mirë që nuk ka ndodhur asnjëherë në rastet e pakta të zbatimit të kësaj dispozite që gjykata të dënojë, më pak akoma prokuroria të marrë në përgjegjësi penale njerëz në bashkëpunim për kryerjen e ndërtimit, por gjithmonë ai që është identifikuar si përfitues i ndërtimit, ai është marrë në përgjegjësi. Tani, nëse nuk ka ndodhur për 6- 7 vjet rresht kjo histori nuk ka sesi të ndodhë me pa e thënë ne. Prandaj ne duhet ta shprehim qartësisht këtë vullnet. Të gjithë këtë zinxhir personash ne duhet ta dënojmë dhe këtë duhet ta vëmë në ligj, për të mos ia lënë rastësisë.

Për propozimin që bëhet për heqjen e termit “punim”, disa gjëra duhet të thuhet. Në pikën 16 të nenit 3 të ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin” thuhet: “Leje ndërtimi është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse”, që do të thotë leje ndërtimi i jepet për ndërtime dhe për punime. Ndërkohë neni 39, të cilit iu referua kolegu, është një nen, që bën fjalë për ato punime të cilat për shkak të natyrës jo thelbësore të ndërhyrjes janë punime për të cilat nuk ke nevojë të marrësh leje tek autoriteti, por bën një deklaratë paraprake dhe e ka të specifikuar. Se cili është punimi atë e përcakton Rregullorja e Zhvillimit të cilën e pasuron apo e pakëson me vendim Këshilli i Ministrave. Ky është mekanizmi që na ka dhënë ligji. Duam apo nuk duam, për ta kuptuar këtë nen, do të shkojmë te ky ligj.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Mendoj se është i justifikuar arsyetimi që bëri relatori për t'i dhënë peshën e vet secilit moment në këtë proces paligjshmërie për të mundur që të mos ngatërrojmë atë që bën rregullimin e dritareve me atë që bën një pallat për qëllime fitimi. Ndarja e përshkallëzuar e përgjegjësisë dhe vendosja e tre paragrafëve dhe qartësimi që u bë mendoj se janë të plotë.

Gjithsesi, kolegët u shprehen, ministrja u shpreh.

Kush është dakord me propozimin e relatorëve me plotësimin që i bëri zoti Subashi? Kundër? Zoti Peza është kundër. Abstenim? Nuk ka.

Dakord.

Neni 3. Kush është dakord në tërësi? Dakord. Kalon në tërësi. Miratohet me ndryshimet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit zonja Ministre!

Kemi një ndryshim rendi dite për shkak të agjendës së seancës dhe duam të ecim me projektligjet që kalendari na imponon.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar””. (*Shqyrtimi nen për nen*)

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Edlira Jorgaqi – Drejtore e Kodifikimit nga Ministria e Drejtësisë

Katrin Treska – specialiste nga Ministria e Drejtësisë

Ilir Bejko – specialist nga Ministria e Drejtësisë

Miran Kopani – këshilltar nga Gjykata e Lartë

Alma Kodraliu – këshilltare nga Gjykata e Lartë

Manjola Xhaxho – përfaqësuese e Gjykatës së Lartë

Artur Graham – përfaqësues i OSBE

Ama Kraja – përfaqësuese e OSBE-së

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë””.

Neni 1.

Armando Subashi – Unë dua të them shumë shkurt se mbasi u njoha dhe me propozimet dhe rekomandimet e ardhura nga Gjykata e Lartë, nga OPDATI, nga OSBE-ja dhe nga misioni EURALIUS, jam munduar që një pjesë të atyre propozimeve t’i shkrijmë në draftin ekzistues për atë që ka qenë e mundur, sepse për një pjesë të tyre ndoshta nuk ka qenë e mundur, por veçanërisht për propozimet e ardhura nga Gjykata e Lartë lidhur me problemin e ndihmësve ligjorë, sipas pikëpamjes sime, ky është një moment shumë i rëndësishëm, i cili ndofta ka nevojë që të shikohet dhe të debatohet gjerësisht duke e parë problemin në thellësi dhe gjerësinë e vet. Unë i bashkohem pikëpamjes së atyre që ndihmësit ligjorë janë shumë të rëndësishëm në gjykata. Ne jo pa qëllim në gjykatat Administrative e futëm këtë koncept dhe i hapëm rrugën gradualisht që problemi i ndihmësve ligjorë të vihet pothuajse gradualisht dhe sipas mundësisë që ka shteti në të gjitha gjykatat. Kështu që nga kjo pikëpamje roli i ndihmësve ligjorë duhet parë si shumë i rëndësishëm në një gjykatë dhe përcaktimi i pozicionit të tyre në ligjin e Gjykatës së Lartë sigurisht që do t’i hapë rrugën edhe përcaktimit pothuajse të të njëjtit pozicion në të gjitha gjykatat e tjera, sepse nëse do të vendosim një standard këtu pa dyshim që ky është një standard që do të mbahet në të gjitha nivelet tjera dhe nuk mundet që ndihmësit ligjorë të Apelit Administrativ të kenë tjetër status, tjetër standard dhe ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë të kenë tjetër status, kështu që nga kjo pikëpamje unë nuk është se paragjykoj apo kundërshtoj apriori propozimet e ardhura, por gjykoj që ndoshta problemi i ndihmësve duhet parë më në thellësi dhe në momentin që do të fillojë reforma në gjyqësor dhe pa dyshim një pjesë e rëndësishme e reformës, do të jetë besoj edhe ky problem. Kështu që nga kjo pikëpamje unë u propozoj kolegëve që propozimet e Gjykatës së Lartë në raport me ndihmësit të mos i marrim në

shqyrtim në këtë draft, por të marrin kohën e nevojshme dhe ta zgjidhin ndoshta në mënyrë përfundimtare, ndoshta shumë më të mirë të gjithë këtë proces. Në fakt kjo bën sens, sepse edhe ndryshimet që kolegët kanë sjellë për ligjin “Për Gjykatën e Lartë” në fakt kanë të bëjnë me një moment shumë specifik dhe shumë deciziv në të cilin ndodhemi. Bëhet fjalë pikërisht për një lloj situatë të krijuar midis parlamentit dhe presidentit në emërimi e anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Kështu që kolegët, me çfarë duket, qartë kanë sjellë vetëm ato propozime që synojnë t’i hapin rrugë ose të zgjidhin në një lloj kuptimi këtë situatë. Sepse pa dyshim që po të ulemi ndoshta ligji “Për Gjykatën e Lartë” ka nevojë për shumë e shumë ndryshime të tjera, por le t’ia lëmë këtë një periudhë të mëvonshme që besoj do të jetë shumë e shpejtë brenda 2-3 muajve, sepse besoj edhe reforma në gjyqësor do të fillojë shumë shpejt dhe padysim që kjo do të jetë një nga gjërat që ne do të diskutojmë gjerësisht për ta përfshirë sigurisht në të gjithë këtë projekt. Kështu që në projektin që kanë paraqitur kolegët nga ai që paraqis unë sot parashikohen vetëm disa ndryshime të vogla që përgjithësisht kanë reflektuar propozimet e ardhura dhe konkretisht te neni 1 është marrë në konsideratë një propozim që ka bërë OSBE-ja lidhur me pikën 7 të germës 2 që ka të bëjë me dokumentacionin zyrtar të institucioneve shtetërore përgjegjëse në fushën e tatimeve, regjistrimit të interesave private, deklarimit dhe kontrollit të pasurive, konfliktit të interesit. Pra, të shtohet kjo shprehje në këtë pikë duke marrë në konsideratë propozimin të ardhur nga OSBE-ja. Pra, pika 7 bëhet: “transparencës së plotë dhe të dokumentuar të të gjitha të ardhurave dhe aseteve, si dhe pagimit të të gjitha detyrimeve tatimore” bazuar në dokumentacionin zyrtar e kështu me radhë, siç e përmenda edhe më sipër. Dhe në shkronjën “b” pika e dytë, ka dy pika, 1 dhe 2, në pikën 2 propozohet: “sipas propozimit që ka bërë misioni EURALIUS, “përbërjes së trupës gjyqësore në momentin e emërimit të kandidatit, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit me synim arritjen e një balance sa më të drejtë gjinore”. Pra kjo është shtuar. Pak a shumë është thënë dhe në projektin e kolegëve, por është bërë një riformulim ndryshe duke marrë në konsideratë propozimin që ka bërë EURALIUS-i.

Për sa i përket nenit 2, unë nuk kam ndonjë propozim shtesë. Pra, neni 2 është ai që kanë propozuar kolegët.

Për sa i përket nenit 3 nuk kam ndonjë propozim shtesë, pra është ai që kanë propozuar kolegët.

Te neni 4 shtohet 4/1-shi, ku bëhet fjalë për marrjen e informacioneve zyrtare.

Së pari, mendoj se ky nen të titullohet duke marrë titullin, pra neni 4/1: “marrja e të dhënave dhe informacioneve zyrtare” dhe të shtohet një paragraf i dytë. Pra, paragrafi i parë mbetet pothuajse ashtu siç është dhe të shtohet një paragraf i dytë. Këto akte bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t’i vihen në dispozicion kandidatit mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar. Pra, është një propozim që ka ardhur nga EURALIUS-i dhe ka të bëjë me një lloj transparence ku kandidatët të kenë të drejtën të njihen me atë lloj informacioni që mund të ketë ardhur në drejtim të tyre dhe që disponohet tashmë në rrugë zyrtare nga Presidenti i Republikës, sepse presupozohet që informacioni aty ka qenë zyrtar, i ardhur në mënyrë zyrtare, dhe nuk ka asnjë arsye që kandidati të mos dijë atë çka Presidenti i Republikës mund të ketë mbledhur në rrugë zyrtare rreth personit të tij. Sigurisht nëpërmjet një kërkesë ai mund të kërkojë që ky material t’i vihet në dispozicion. Pra, këto ishin pak a shumë ato që unë kam mundur të reflektoj në nenet konkrete mbi bazën e propozimeve që kanë ardhur nga aktorët që përmenda më sipër. Nenet e tjera ngelen të pandryshuara, kështu që mbi këtë bazë, kryetar, unë bëra një relativitet të përmbledhur të shtesave që propozoj dhe besoj se mund të vazhdojmë me procedurën për t’i mbyllur nen për nen të gjitha.

Fatmir Xhafaj – Për nenin 1 ka ndonjëri ndonjë gjë për të shtuar?

Ministria jeni dakord? Faleminderit!

Neni 2. Ka ndonjë gjë përkundrejt asaj që është propozuar, sepse neni 2 nuk ka ndryshuar. Dakord. Po.

Miran Kopani - Në lidhje me pikën “i” të neni 1 që vë si kriter momentin e emërimit të kandidatit, duke synuar balancën ndërmjet personave, anëtarëve, me qëllim funksionimin e kolegjeve të specializuara, siç e sqaruar dhe dje, kolegjet nuk janë statike në Gjykatën e Lartë. Ato janë të ndryshueshme, të paktën në praktikë ka qenë 1 herë në 2 vjet. Në qoftë se për një moment të caktuar, për shembull, vendi është vakant, një gjyqtar në Kolegjin Penal nuk do të thotë automatikisht që gjyqtari që vjen në këtë kolegji duhet të jetë detyrimisht penalist. Siç ju thashë, kolegjet, me mendimin edhe të gjyqtarëve, kryetari i Gjykatës së Lartë, i ndryshon dhe kjo do të përbënte një si lloj pengese.

Fatmir Xhafaj – Me sa kuptoj unë nuk është kjo. Kjo është: “përbërjes së trupës gjyqësore”. Pra, trupa gjyqësore si e tërë, nuk ka lidhje me kolegjet. Ndoshta e keni keqkuptuar. Është përbërja e trupës gjyqësore si e tërë. Çfarë nënkupton kjo? Kjo nënkupton që në një moment të caktuar mund të çmohet dhe të thuhet se kjo trupë gjyqësore duhet të ketë dhe civilistë dhe penalistë etj. Atëherë duhet të thuhet se ne kemi nevojë këtu për penalistë. Ky është një kriter shtesë që bëhet. Pra, trupa gjyqësore si e tërë. Pa dyshim ne e dimë që kolegjet ndryshojnë. Mund të ndryshojnë dhe nga një vit në tjetrin për organizime të brendshme të gjykatës. Ne nuk i hyjmë kësaj. Është trupa gjyqësore si e tërë. Besoj se u sqaruam.

Faleminderit!

Neni 1 u miratua gjithsesi. Për korrektesë u dëgjua dhe më mirë akoma, sepse na u dha mundësia dhe të sqarohemi.

Neni 2 ramë dakord. Nuk ka ndryshime.

Neni 3 nuk ka ndryshime. Dakord.

Neni 4 me ndryshimin që ka propozuar relatori, duke reflektuar te rekomandimet e Misionit EURALIUS dhe OSBE-së? Jeni dakord? Dakord.

Ka kundërshtime, shtesa? Dakord.

Faleminderit!

Neni 6. Jemi dakord.

Neni 7. Dakord ministria, Gjykata e Lartë? Faleminderit!

E mbyllim këtu.

Faleminderit për mirëkuptimin!

(Zoti Subashi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Dakord. Sipas propozimit që ka bërë Gjykata e Lartë? Dakord.

E mbyllim këtu dhe më pas do ta votojmë në tërësi për efekt kuorumi.

Faleminderit, zoti Kopani!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 11.30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

Albana Koçiu – drejtore e DAP-it

Jusilda Bocaj – këshilltare e ministres për median

Iris Petrela – përfaqësuese e OSBE-së

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Dashamir Peza, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Fatmir Xhafaj - Tani kalojmë te projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në lidhje me borxhin shtetëror, është ministria? Nuk është. Mund të fillojmë. Kur të vijë ministria, le të hyjë, por ne të bëjmë një prezantim të përgjithshëm se çfarë është ndryshuar.

Po zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dje ne dëgjuam prezantimin e dy projektligjeve të sjella nga qeveria ndërkohë në cilësinë e relatores, por së bashku dhe me kolegët ne parashtruam një sërë pyetjesh. Meqenëse ligji “Për nëpunësin civil” është një ligj i ri, i cili është miratuar me konsensus ka sensibilitet dhe paraqet interes publik besoj se ishte në interes të dëgjonim se cilat kanë qenë dhe problemet që kanë nxjerrë zbatimin e këtij ligji.

Sikurse u tha dhe dje qoftë dhe nga prezantuesit të projektligjit në emër të qeverisë, por dhe nga unë ndryshimet e propozuara në ligj synojnë të rregullojnë si kontradiktat që vihen re në ligje, pra kur dispozitat e ligjit bien ndesh me njëra- tjetrën edhe për të rregulluar situata të parregulluara. Për shembull një nga rregullimet që bëhet në ligj është rregullimi i varësisë së departamentit të administratës publike që aktualisht ne kemi një ministere të Inovacionit dhe Teknologjisë, dhe Administratës Publike ndërkohë që në ligjin e miratuar ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Ndryshim tjetër që kërkon të rregullohet është një kategori e punonjësve, statusi i të cilëve rregullohet edhe me ligje të veçanta dhe ishin të parashikuar si nëpunës të shërbimit civil ndërkohë që ky lloj rregullimi shpesh vinte në vështirësi ata kur kishte nevojë për mobilitet, për lëvizshmëri, për shkak të punës që kanë. Për shembull, oficerët e Policisë Gjyqësore, civilët në Forcat e Armatosura, ose sikurse ishte rasti i punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që u kërkua edhe nga Banka Botërore dhe FMN-ja për të pasur status të veçantë. Gjithashtu, në ligj është rregulluar më mirë me ndryshimet që propozohen marrëdhëniet midis Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Departamentit të Administratës Publike. Shkolla është e pavarur, por ndërkohë nuk mund të mos ketë një bashkëpunim midis Departamentit të Administratës Publike që menaxhon të gjitha problemet që ka administrata publike lidhur me rekomandimin për politikat e trajnimeve që duhet të bëjë shkolla shqiptare e administratës publike.

Një nga problemet që ka rezultuar në këtë periudhë edhe nga përgjigjet që dhanë dje qoftë ministria Harito, qoftë drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike është lista e fituesve në konkurse, megjithëse kemi një listë më të gjerë të fituesve në konkurse një pjesë e fituesve nuk sistemohen në punë për shkak se nuk ka vende të mjaftueshme. Ne propozojmë që të krijohet mundësia që vendet e lira që krijohen në mënyrë të përkohshme në administratën publike të zëvendësohen pikërisht nga persona që gjenden në listë, të cilët nuk kanë filluar ende punë. Kjo është e logjikshme, sepse këta janë persona që kanë marrë ato që ne themi 70 pikëshin, janë shpallur fitues, por për shkak të mungesës së vendeve të lira nuk mund të punojnë. Në këtë kuadër ne sugjerojmë që me pëlqimin e kandidatit kur ka vende të krijuara në mënyrë të përkohshme ata të sistemohen në punë gjithmonë me pëlqimin e kandidatit.

Gjithashtu, në propozimet që sjellim në ligj ne kërkojmë të unifikojmë dhe praktikat e rekrutimit qoftë kur bëhen lëvizjet, plotësimet e vendeve me lëvizje paralele, apo kur bëhet me plotësimet e vendeve nëpërmjet konkursit, me prurjet nga jashtë. Në të gjitha rastet personat duhet të marrin 70 pikë. Në fakt ka pasur një diskutim të kësaj praktike që ndjek Departamenti i Administratës Publike me SIGMA-n. SIGMA ka kërkuar që ligji të jetë më fleksibël, ndërkohë që administrata publike dhe kjo maxhorancë ka kërkuar kritere të forta të konkurrimit dhe standarde të unifikuara për çdo person që kërkon të punojë në administratën publike. Një tjetër që rregullohet në këtë propozim është edhe plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme me persona që mund të jenë edhe jashtë shërbimit. Për të gjithë ju të nderuar kolegë e dini që ne me këtë ligj kemi krijuar një administratë unike. Pra, çdo lëvizje në administratë bëhet në bazë të konkurrimit, ka një rregull të caktuar. Megjithatë kjo është administrata që ne kemi theksuar që mund të ketë nevojë në pozicione të caktuara për persona që kanë njohuri të veçanta për persona që kanë kualifikime të veçanta që ne nuk i gjejmë brenda një institucioni të caktuar. Në këtë kuadër është diskutuar edhe me SIGMA-n dhe është sugjeruar që të vendosen kufizime, të hapet procedura edhe për kategorinë e personave që mund të vijnë jashtë institucioneve të administratës shtetërore dhe organeve të pavarura. Por duhet të ketë një kuotë të caktuar, një përqindje të caktuar. Pra, nuk duhet të abuzohet me këtë dhe duhen përcaktuar qartësisht kriteret kur mund të merren këta persona nga jashtë sistemit të administratës.

Konkretisht është sugjeruar që në çdo rast plotësimi i këtyre vendeve të lira me këta persona që shpallen, përjashtimisht nuk duhet të kalojë 20%-shin e numrit total të vendeve në

çdo vit kalendarik. Por për të gjitha rastet, pavarësisht se personi merret nga lëvizje paralele, pavarësisht se personi merret nëpërmjet listës, gjithmonë ai do t'i nënshtrohet konkursit dhe gjithmonë do të përzgjidhet vetëm kur të ketë marrë atë kufij pikësh që thamë, 70%-shin e pikëve të konkursit. Pra, konkursi në çdo rast është i zbatueshëm.

Gjithashtu, ne kemi diskutuar edhe lidhur me Komisionin Kombëtar të Përzgjedhjes së Trupës së Lartë Drejtuese. Është kërkuar dhe është sugjeruar dhe po të shikoni, kemi bërë një sugjerim për t'i lënë numrin e trupave siç ishin. Pra, tërhiqen përfaqësuesit e qeverisë nga propozimi për të ulur numrin dhe kjo është e drejtë, sepse ne respektojmë parimin e sigurisë juridike. Nga diskutimet që kemi pasur deri në orët e vona, dje, të grupit të punës midis ministres së Teknologjisë së Informacionit dhe të Administratës Publike, drejtoreshës së DAP-it, këshilltarëve të Kuvendit të Komisionit të Ligjeve dhe me mua si relatore, së bashku me disa ekspertë të çështjeve të administratës publike, thamë që është shumë i rëndësishëm të respektohet parimi i sigurisë juridike. Pra, përderisa njerëzit tashmë janë zgjedhur Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes dhe Këshilli Drejtues i shkollës është i zgjedhur, ne nuk mund t'u themi njerëzve tashmë që ju duhet të lëvizni nga pozicioni, sepse ne po shkurtojmë numrin e përbërjes së komisionit, pavarësisht se një komision më i vogël do të ishte më i menaxhueshëm dhe më pak i kushtueshëm nga pikëpamja financiare. Megjithatë parimi kushtetues prevalon dhe ne respektojmë parimin kushtetues.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, kemi sjellë një propozim për të parandaluar diskriminimin midis trajtimit të institucioneve të administratës shtetërore, institucioneve të pavarura, ku përfshihen dhe organet e qeverisjes vendore, lidhur me mundësinë që dhe këta për nevoja specifike, kur kanë nevojë dhe nuk kanë kapacitete brenda institucionit të tyre, të shpallin përjashtimisht marrjen, rekrutimin edhe nga jashtë sistemit, sidomos kur ka persona të cilët kanë aftësi në fusha të caktuara për të cilat ne kemi nevojë.

Gjithashtu, në përgjigje të shqetësimit që ngriti drejtoresha e DAP-it, zonja Koçiu, ne duam t'u japim fund rasteve që, kur një pozicion shkurtohet për shkak të mbylljes së institucionit dhe ristrukturimit, t'i lëmë peronat pa punë, ose pa një zgjidhje. Ligji aktual nuk i ka dhënë zgjidhje se çfarë do të bëhet me këta persona.

Sipas informacionit shtesë, që morëm dje, rezulton se këta persona mbeten pezull, pra nuk kanë mundësi punësimi, ndërkohë që ristrukturimi i institucionit, ose mbyllja e vendit të

punës, nuk është për faj të tyre. Në këtë kuadër, kemi parashikuar ndryshime që i sjellin ligjit një mbrojtje më të mirë të nëpunësve civilë në këto detyra dhe mundësinë që ata të sistemohen me përparësi, madje edhe duke i transferuar. Meqenëse për disa institucione mundësia për t'u transferuar në një distancë prej 30 kilometrash është e pakët dhe nuk ka institucione që të kenë dikasteret e tyre në këtë distancë, sugjerojmë që distanca të shkojë deri në 45 kilometra, pra të ketë një rritje proporcionale dhe gjithmonë transferimi të bëhet me pëlqimin e personit. Pra, askush nuk mund të detyrohet të transferohet pa pëlqimin e tij. Në këtë mënyrë i japim zgjidhje problemit që personi të mos mbetet pa punë.

Gjithashtu, në ligj kemi rregulluar edhe mënyrën se si mund të përfundojë marrëdhënia në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit ose të mbylljes së institucionit. Deri më sot, këto ndryshime e vinin punonjës në pozitë diskriminuese. Sugjerojmë që punonjësi i cili largohet për shkak të ristrukturimit ose të mbylljes së institucionit, ka të drejtë të marrë pagesë. Njëkohësisht, ai ka të drejtë të konkurrojë për të njëjtën kategori, në lëvizjet paralele ose një kategori më lart, për rritje detyre. Pra, nuk mund të flaken personat në rrugë, më falni që po përdor këtë term, kur ata mund të kenë një përvojë të gjatë dhe, për fatin e tyre të keq, bëhet ristrukturimi ose mbyllja e institucionit. Në bashkëpunim edhe me SIGMA-n është diskutuar se si do të jetë pagesa e tyre dhe është sugjeruar që të merret si pagë, duke pasur parasysh eksperiencën e punës në shërbimin civil. Sa më përvojë të ketë, aq më shumë pagesë do të marrë. Në ligj i kemi të specifikuar dhe të kategorizuara, sipas përvojave, edhe pagat që do të marrë punonjësi.

Të nderuar kolegë, në ligj kërkojmë të rregullojmë më së fundi edhe një problem shumë të rëndësishëm, siç është pezullimi. Ju e dini që ligji për nëpunësin civil, ligji i ri, i jep mundësi personit që të pezullojë punën për një periudhë të caktuar kohe, padyshim me miratim nga titullari, dhe më pas, për interesa të tij, të rikthehet në punë. Mirëpo çfarë ndodh? Nëse një person kërkon të mos punojë për një vit apo dy, me kërkesën e tij, dhe rikthehet pas dy vjetësh, por vendi i punës është zënë, administrata publike nuk mund të mbajë bosh vendin e drejtorit të Përgjithshëm, vendin e një juristi, vendin e një shefi sektori, meqenëse një person mund të ketë vajtur për studime, do të punojë pranë një organizate ndërkombëtare, ose ka interesa të tjera të ligjshme. Gjatë kohës që personi është i pezulluar, puna e tij bëhet nga dikush tjetër. Ligji nuk e rregullon se çfarë bëhet kur personi kthehet dhe vendi i tij është i plotësuar, ose i suprimuar, sepse nuk ekziston më sektori apo departamenti ku ka punuar.

Në këtë kuadër, ne e rregullojmë këtë situatë dhe sugjerojmë që nëpunësi duhet të kthehet në pozicionin e mëparshëm, kur ai nuk është i plotësuar, por nëse është plotësuar, ai mund të transferohet në një vend tjetër, por me të njëjtën kategori. Sugjerojmë që, nëse kjo nuk është e mundur, nëpunësi të regjistrohet në një listë që administrohet nga njësia përgjegjëse dhe i afrohen më pas mundësitë e punësimit, sipas kushteve që parashikon ligji “Për nëpunësin civil”.

Këta persona mund të emërohen edhe përkohësisht, nëse krijohen vende të lira në mënyrë të përkohshme, gjithmonë me dëshirën e tyre. Gjatë periudhës së pezullimit, nëpunësi civil nuk përfiton pagë, por pas periudhës kur kërkon të kthehet në punë, fillojnë efektet e zbatimit të ligjit, prandaj njësia përgjegjëse përgjigjet që do të marrë masa për sistemimin e personit, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Një nga rregullimet që bën ligji, është vlerësimi në punë. Besoj se nuk është e panjohur për të gjithë ju, që në administratë jo të gjithë njerëzit kanë të njëjtën performancë. Një pjesë punon më shumë, një pjesë më pak. Pra, në shumë institucione puna përqendrohet në pak duar. Një pjesë e njerëzve bëjnë sehir, por e marrin rrogën një lloj me të parët. Në këtë kuadër, ligji rregullon vlerësimin në punë, por kërkojmë të forcohen rregullat e tij.

Çfarë kërkohet? Kërkohet që vlerësimi i rezultateve të punës të bëhet jo vetëm për realizimin e objektivave të caktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, por të vlerësohet, gjithashtu, nëse personi i ka përvetësuar njohuritë shtesë për realizimin e funksioneve. Në Shqipëri legjislacioni ndryshon shpesh, sepse jemi të detyruar ta përafrojmë atë me të BE-së, kështu që nuk mund të kemi në administratë persona që mund të njohin ligjin bazë, por nuk njohin standardet e tjera. Jo vetëm që nuk i njohin, por nuk punojnë për rritjen e profesionalizmit të tyre. Në këtë kuadër, kërkojmë që të rregullojmë mënyrën e vlerësimit. Në rast se personi vlerësohet jo kënaqshëm nga procedura e njohurive shtesë, t’i japim një shans që të bëjë një trajnim të detyrueshëm për të plotësuar njohuritë. Më pas, të bëhet një vlerësim nëse, pas trajnimit, e ka rritur sasinë e informacionit dhe të dijeve të tij.

Me propozimet që bëjmë sot, ne rregullojmë përfundimisht një problem që do të thosha se është gangrenë në sistemin e administratës publike: konkretisht, vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, të cilat, siç e dini, prej vitesh flenë nëpër sirtarë dhe nuk është e mundur të zbatohen. Të gjithë jemi dakord që parimi kushtetues, i parashikuar në nenin 142 të Kushtetutës, “Vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të

detyrueshme për zbatim dhe nuk vihen asnjëherë në diskutim”, është vendim që na ka udhëhequr në debatin që kemi bërë dje në mbledhje dhe kemi theksuar që, pavarësisht se në Kushtetutë shprehet kjo gjë, duam të përcaktojmë mekanizmat se si ky parim kushtetues të zbatohet në shërbimin civil, duke kërkuar që vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësit civil të zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse. Nëse rikthimi nuk është i mundur objektivisht, sepse mund të kemi dy persona për të njëjtin vend, apo vendi është plotësuar sipas procedurës së rregullt, atëherë të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil. Nëse nuk është e mundur, personin ta regjistrojmë në një listë, të cilën e administron njësia përgjegjëse, dhe me krijimin e vendit të punës, të emërohet menjëherë, me pëlqimin e tij, duke respektuar edhe kategorinë përkatëse. Sigurisht, nëse ai plotëson kriteret e pozicionit të punës.

Lidhur me dispozita e tjera, nën pas neni, do të themi se ku kemi hequr dorë ose nuk mbahen parasysh.

Më lejoni, zoti kryetar, t’ju falënderoj për mundësinë që na dhatë për të diskutuar mbledhje, por në mënyrë të veçantë për diskutimin shumë konstruktiv që kemi pasur me zonjën Harito, me zonjë Koçiu dhe me ekspertët e çështjeve administrative!

Falënderoj në mënyrë të veçantë edhe këshilltaren e Komisionit të Ligjeve, që ka bërë një punë të jashtëzakonshme!

Nëse më lejoni, kam edhe një shqetësim që dua ta adresoj. Edhe pse kemi bërë dje kaq shumë diskutime, në ligj nuk kemi zgjidhur problemin e barazisë midis Trupës së Lartë Zgjedhore të administratës shtetërore dhe të një institucioni të pavarur, sepse në një institucion të pavarur, me pëlqimin e nëpunësit dhe me miratimin e DAP-it, mund të zgjidhet drejtpërdrejt një anëtar i trupës së lartë, por kjo nuk ndodh në rast të kundër, që një nëpunës i lartë i trupës në institucion të pavarur, me pëlqimin e tij të zgjidhet në një institucion të administratës shtetërore. Kjo është një pabarazi, sepse edhe në institucionet e pavarura mund të ketë ekspertë shumë të mirë, siç mund të jenë këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë apo në parlament, të cilët bëjnë ligje dhe gjithçka tjetër, por dalin që janë të pavlefshëm për administratën shtetërore, ndërkohë që e kundërta mund të ndodhë: një punonjës i administratës shtetërore, vetëm se ka bërë shkollën e ASPA-s, është i vlefshëm për të punuar nëpër institucione. A do të mund t’i fusim punonjësit e institucioneve të pavarura ta bëjnë me detyrim

shkollën e ASPA-s dhe të mundësojmë zgjidhjen e këtij konflikti, diskriminues në dukje, që është në nenin 30?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Pas këtij prezantimi të hollësishëm të të gjitha ndryshimeve që i janë bërë projektligjit, në të gjitha amendamentet e tij, shtesat e ndryshimet e mundshme, të cilat, siç i prezantoi zonja Hysi me shumë kompetencë, janë fryt i një diskutimi konstruktiv me përfaqësuesit e qeverisë dhe ekspertët. Këto paraqitje, për të shpjeguar se cilat janë risitë, nevojat që i shtynë këto ndryshime, por edhe efektet pozitive që krijohen nga këto ndryshime, besoj se janë të mjaftueshme dhe të qarta. Për opinionin publik, mbase do të jenë akoma më të njohura, pasi të dalë raporti përfundimtar i komisionit, me argumentet përkatëse, por edhe në momentin e votimit në seancë plenare.

Vazhdojmë me nenin 1.

Besoj se janë të qarta.

Vasilika Hysi – Vetëm një gjë: kemi ndryshuar numrat e neneve. Ngaqë janë shtuar nenet në projektligjin e sjellë nga qeveria, numrat kanë evoluuar.

Në seancë do të shkojë projekti i integruar i të dyja nismave, plus ndryshimet që sugjerojmë.

Do të sugjeroja, këshilltarja që do ta zbardhë variantin, të ketë kujdes që të mos përplasen numrat e neneve.

Fatmir Xhafaj – Ju do ta mbikëqyrni.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – A ka probleme për nenin 1?

Zonja ministre.

Milena Harito – Meqë dje u diskutua çështja e bordeve të kullimit, doja të saktësoja se, megjithëse quhen borde, janë në fakt institucione varësie. Sugjerimi është: nuk ka ndonjë arsye të veçantë që të trajtohen në këtë nen. Nëse ka nevojë për ndonjë rregullim të veçantë, do ta shikojmë me aktet ligjore.

Kemi edhe çështjen e Avokatit të Shtetit.

Fatmir Xhafaj – Besoj se Avokati i Shtetit është një shërbim shumë i rëndësishëm, por i një natyre specifike, që nuk duhet trajtuar me shërbimin civil, edhe për një arsye tjetër, pasi mendojmë se në kuadrin e reformës në drejtësi do të jetë një qendër që do të shërbejë edhe si praktikë për magjistratët e rinj, pra, do të thotë se do të ketë një status specifik.

Biem dakord, zonja Ministre?

Milena Harito – Po.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pas nenit 1, shtohet neni 2, si vijon: “Në nenin 3, pika 2, hiqet germa “b” dhe pika 2 riformulohet si vijon: “Mund të rregullohen me ligj të posaçëm elementet në marrëdhënien e shërbimit civil në shërbimin e jashtëm”. Dakord?

Dakord.

Faleminderit!

“Neni 1 i projektligjit numërohet 3 dhe nuk pranohet propozimi i sjellë nga Këshilli i Ministrave, por sugjerohet të shfuqizohet pika 2 e nenit 6 të ligjit në fuqi”. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 2 numërohet 4 dhe sugjerohet të ndryshohet si vijon: “Kudo ku në ligj përdoret terminologjia “ministri ose Ministria e Brendshme”, i referohet “ministri ose ministria përgjegjëse për administratën publike”.

Më falni, mos duhet “ministri përgjegjës për administratën publike”, sepse nuk është ministria përgjegjëse?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Me këtë korrigjim që bëmë, miratohet.

Neni 3 numërohet 5 dhe riformulohet si vijon: “Në nenin 7 bëjmë këto shtesa dhe ndryshime...”.

Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Milena Harito – Ka një gabim ortografik: për administratën dhe jo administrimin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 4 numërohet 6 dhe ndryshohet si vijon: “Në nenin 8 të ligjit ekzistues bëhen këto ndryshime në pikën 4”. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pas nenit 4 të projektligjit, numërtuar 6, shtohen tri nene, përkatësisht 7,8 dhe 9, si vijon... Në nenin 7, neni 23 i ligjit ekzistues, në fund të pikës 3 shtohet pika 3.1 si vijon... Në nenin 8, neni 25 i ligjit ekzistues, ndryshohet në titull dhe në pikën 4 si vijon: “Lidhja paralele në kategorinë ekzekutive”. Në nenin 9, neni 26 i ligjit ekzistues, ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si vijon: “Neni 26. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”.

Dakord, zonja Ministre?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 5 i projektligjit numërohet 10 dhe nuk pëson shtesa dhe ndryshime. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kemi nenin 30, pika 5, me TND-të, një gjë që e trajtoi zonja Hysi. Do të doja një koment, sepse nuk bën sens. Ato që janë përfshirë në TND-të hyjnë në institucionet e pavarura, por anasjelltas nuk ndodh. Atëherë, mbajini në nivelin qendror, pra institucionet e pavarura në nivel qendror. Një këshilltar në Kuvend apo në Gjykatë Kushtetuese duhet ta gëzojë këtë status.

Milena Harito – Është një problem që nuk është konsultuar me komisionin, por ky nuk është problem shumë i madh në vetvete. Çështja është se do të duhej të kishte kritere pranimi.

Fatmir Xhafaj – Të njëjtat kritere i bëjmë dhe i rregullojmë në ligj. Dakord?

Milena Harito – Nëse janë të njëjtat kritere pranimi, nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Jam dakord që kriteret e administratës të jenë të njëjta. A mund të bëjmë një formulim që të jenë të njëjtat kritere pranimi?

Fatmir Xhafaj – Ramë dakord.

Dakord edhe me këtë ndryshim.

Vazhdojmë me nenin 6, që numërohet 11 dhe ndryshohet si vijon: “Nuk pranohet propozimi i Këshillit të Ministrave për ndryshime në pikat 1 dhe 2 të nenit 31, por sugjerohet që në nenin 31 të ligjit ekzistues, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të ndryshohen si vijon: a) një përfaqësues nga DAP-i, i cili kryeson komisionin; b) dy përfaqësues nga ASPA, nga të cilët njëri është jo nëpunës i ASPA-s”. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 7, numërohet 12 dhe ndryshohet si vijon: “Në pikën 1, sipas variantit të sjellë nga Këshilli i Ministrave, propozohet që pas togfjalëshit “institucionet e pavarura”, shtohet togfjalëshi “ dhe njësitë e qeverisjes vendore, si dhe pas togfjalëshit “për kandidatët e tjerë”, shtohet togfjalëshi “jashtë shërbimit civil”.

Me ndryshimin e pikës së mësipërme, pika 1 bie dhe mbetet rregullimi i mësipërm. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pas nenit 12, shtohen nenet 13 dhe 14 si vijon: neni 33.3 sugjerohet të shfuqizohet; neni 14, në nenin 48.2, shkronja “b”, togfjalëshi “30 kilometra” bëhet “45 kilometra”. Dakord, me dy ndryshimet?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 8, numërohet 15 dhe ndryshohet si vijon: “Në nenin 50 bëhen këto shtesa e ndryshime. Pika 6 ka ndryshuar sipas konceptit që është në tabelë. Pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9 me përmbajtjen që keni dhënë. Dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Shtohet neni 16 si më poshtë vijon: “Në nenin 54, pika 1, shkronja “a”, referenca në shkronjën “g” zëvendësohet me shkronjën “gj””. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Shtohet neni 17 si më poshtë vijon: “Në nenin 55, pika 2, pas togfjalëshit “një interesi tjetër...” shtohet togfjalëshi “sipas përcaktimeve të vendosura nga Këshilli i Ministrave”. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Shtohet neni 18 si më poshtë vijon: “Në nenin 56 bëjmë këto shtesa dhe ndryshime. Neni 56 “Efektet e pezullimit” ka një riformulim të ri sipas formulimit të dhënë në tabelën që kanë kolegët përpara”. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ndryshohet emërtimi i kreut XI si më poshtë vijon: “Vlerësimi i nëpunësit” bëhet “Vlerësimi i nëpunësit civil”. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Në projektligj shtohet një nen i ri 19 si më poshtë vijon: “Në nenin 62 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: 1. Në nenin 26 titulli i dispozitës emërtohet “Vlerësimi në punë” dhe fjalia e parë e pikës 1 ndryshohet siç është paraqitur këtu në tabelë. 2. Pas pikës 1 të nenit 62 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje, siç e sqaroi edhe zonja Hysi në prezantimin e ndryshimeve. Pas pikë 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje.”

Milena Harito – Meqenëse ia keni lënë VKM-së, do të doja të shtonim fjalët “duke garantuar anonimin”, për të përforcuar ligjin. Vlerësimet të bëhen duke garantuar anonimin, pra të jenë të sekretuara.

Fatmir Xhafaj – Ku e keni gjetur këtë qeveri kaq demokratike që nuk do pushtet! Çfarë bëhet kështu?!

Milena Harito – Ja prova.

Fatmir Xhafaj – Ky ndryshim që keni bërë është shumë i rëndësishëm. Pra, provimi do të jetë absolut sekret. Askush nuk do të dijë se kush kandidon.

Milena Harito – Jo, kjo është për vlerësimin e atyre që janë tashmë në administratë.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jemi dakord me propozimin e zonjës ministre për t'i hequr pushtetin e qeverisë dhe për t'ua dhënë atyre që konkurrojnë dhe vlerësohen. Komplimente, zonja Ministre dhe zonja drejtoreshë, për këtë ndryshim të rëndësishëm në ligj!

Shtohet neni 20 me përmbajtjen si më poshtë vijon: “Në nenin 64, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje...” Përmbajtjen e keni në tabelë. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 9 i projektligjit numërohet 21 dhe ndryshohet si më poshtë vijon: “Në nenin 26 të ligjit ekzistues bëhen këto ndryshime dhe shtesa. Në pikën 1 pas shkronjës “a” shtohet “a/1” me përmbajtjen: si rezultat i ngritjes apo ristrukturimit të institucionit sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 50 të këtij ligji në pikën 1 pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “e/1” dhe “e/2” me përmbajtjen: “e/1” në rastin e parashikimeve nga neni 56 dhe “e/2” në rast se nuk vlerësohet përsëri kënaqshëm në përfundim të procedurës të vlerësimit sipas pikës 2/1 të nenit 62”. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Shtohet 22 si më poshtë vijon: “Pas nenit 66 shtohet neni 66/1 lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë. Këtë dispozitë e sqaroj më së miri zonja Hysi në prezantimin që u bëri ndryshimeve. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord. Ju falënderoj që e propozuat, se ky është një nen shumë i rëndësishëm!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka qenë i varur nga institucionet dhe për herë të parë përqendrohet në mënyrë që të garantohet aplikimi i tyre.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Bashkim Fino – Çfarë garancie ka qytetari ose nëpunësi që ka fituar një vendim të formës së prerë të gjykatës të kthehet përsëri në punë, ndërkohë që ju thoni se ka një garanci? Edhe deri dje këtë garanci e kishte nga institucioni përkatës, të cilin e detyronte gjykata ta merrte në punë nëpunësin. Tani e futim në ligjin e nëpunësit civil, por çfarë garancie më shumë ka me këtë?

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Ministre, ju lutem!

Milena Harito – Ndoshta shpjegimin mund ta bëjë zonja Hysi, e cila bëri propozimin.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, keni fjalën, meqë jeni propozuesja e amendamentit.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Në fakt, vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të detyrueshme për zbatim. Zoti Fino, biem dakord që e ka Kushtetuta. Problemi qëndron se në praktikë ne sot kemi shumë njerëz që kanë vendime gjyqësore të formës së prerë, por institucionet nuk i sistemojnë me argumentin që vendi është i zënë ose është suprimuar. Ne kërkojmë që kjo dispozitë të mos mbetet e vdekur, pra që personi ta mbajë vendimin gjyqësor 8-10 vjet në xhep dhe të mos ekzekutohet. Njësia përgjegjëse, që është Departamenti i Administratës Publike, e ka listën e të gjitha vendeve të lira që mund të krijohen, si edhe e menaxhon më mirë situatën. Për shembull, nëse në Ministrinë e Financave është zënë vendi i juristit, por ka një vend juristi në një institucion tjetër, ministri përkatës nuk e di, por drejtoresha e DAP-it e di që është liruar ky vend. Në këtë kuadër, personi që ka një vendim të formës së prerë thirret dhe i thuhet që i është zënë vendi për shkak se konkursin e ka fituar dikush tjetër, i cili nuk mund të hiqet, por në qoftë se plotëson kushtet, kriteret dhe kërkesat e pozicionit të punës, ai sistemohet në vendin e lirë, pa dyshim me pëlqimin e personit. Ndërkohë për një vend punë mund të jenë 2-3 persona, të cilët kanë vendim të formës së prerë të gjykatave dhe diskutimi që bëme ne ishte se cili do të punësohej i pari, pra ai që është hequr para dy vjetësh apo ai që është hequr para një muaji. Në këtë kuadër, duhen regjistruar, pra ne duhet të kemi një database se sa vendime të formës së prerë sipas pozicioneve dhe kriterëve ka. Para se të marrësh dikë nga jashtë sistemit, do të sistemosh këta të parët në punë, pa dyshim në qoftë se plotësojnë kërkesat dhe kriteret që ka pozicioni i punës, në këtë mënyrë ne bëjmë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ju e dini që ne kemi vendime të Gjykatës së Strasburgut që e kanë ndëshkuar Shqipërinë për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore, si edhe pritet të merren edhe disa vendime të tjera nga Gjykata e Strasburgut. Ne nuk mund të lejojmë që taksapaguesit të paguajnë gabimet që bëhen në administratë për heqjet e padrejta nga puna. Po jo gjithmonë heqjet kanë qenë të padrejta dhe ata mund ta kenë fituar përsëri gjyqin.

Megjithatë është edhe një shans tjetër, një risi që unë e sqarova, por mbase duhet të kisha qenë edhe më e qartë. Nëse personi nuk e ka vendin e punës bosh për momentin, por krijohet mundësia që të fillojë punë qoftë edhe përkohësisht derisa të ekzekutohet vendimi i

formës së prerë, njësia përgjegjëse e fton atë dhe i ofron edhe një emërim të përkohshëm derisa të hapet vendi i punës, por vendimet gjyqësore do të ekzekutohen. Mos harroni se personi gjatë kësaj kohe merr pagesë, pra merr rrogë. Ne kemi interes që jo vetëm t'i kthejmë të drejtën dhe dinjitetin personit, pra që ai të kthehet në vendin e punës, por nuk mund të mbajmë edhe fatura financiare, të cilat shpeshherë shkojnë në 80 milionë lekë apo 100 milionë lekë. Pse ndodh kjo?! Sepse një ministër nuk do të marrë një person në punë. Prandaj DAP-i në këtë administratë të unifikuar ka përgjegjësi dhe detyrë të sistemojë çdo person në vendin e tij. Nëse personi i plotëson kriteret apo jo, ne kemi sistemin e vlerësimit. Të gjithë punonjësit e administratës publike, me ndryshimin që i bëme nenit 62, do të vlerësohen. Ne nuk mund mbajmë më njerëz që luajnë “Solitare”, që nuk dinë të hapin kompjuterin, që rrinë gjithë ditën lexojnë gazeta, që rrinë gjithë ditën në kafe. Prandaj kjo është shumë e rëndësishme për të pasur një administratë me performancë të barabartë dhe jo disa të punojnë dhe disa të rrinë. Shumë studentë që kanë mbaruar jashtë rrinë pa punë dhe vendin e punës e mban një njeri që nuk ia ka haberin punës.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Nuk kam gjë ndaj komenteve shumë profesionale që bëri zonja Hysi, por ka një kontradiktë shumë të madhe në këtë që ajo sapo tha. Në momentin që ne themi se e ka Kushtetua që vendimet e gjyqit janë të formës së prerë, Kushtetuta është libri themeltar i shtetit tonë. Në fund të fundit, ajo është shumë herë më lart se një projektligj, siç është ligji i nëpunësit civil. E pra, deri tani e ka Kushtetuta dhe nuk zbatohet! Pyetja që bëra unë ishte se kush më garanton mua se Kushtetuta e ka, po e fusim edhe në ligjin e nëpunësit civil, që është një ligj shumë herë më i vogël se Kushtetuta, që vendimet e formës së prerë të gjykatave do të ekzekutohen menjëherë nga njësia përkatëse që merr punonjësit në punë. Kjo më duket hipokrizi, sepse kur deri dje nuk e ka bërë këtë gjë Kushtetuta, pse do ta bëjë sot ligji?! Pra, ne po shkruajmë sot në ligjin e nëpunësit civil që njësia bazë ka të drejtë ta ekzekutojë vendimin e formës së prerë të gjykatës dhe ta marrë nëpunësin ose t’ia ruajë vendin apo ta paguajë etj. Është debati që bëme edhe dje. Edhe sot e ka për detyrë DAP-i të interesohet që të ketë një database për të gjitha vendimet e formës së prerë të gjykatave. Pra, e ka për detyrë sot DAP-i të gjejë mundësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në të gjitha njësitë përkatëse ku ata janë pushuar nga puna, por gjykata i ka kthyer përsëri në punë. Deri më sot nuk është bërë gjë, por edhe gjatë viteve të kaluara. Atëherë, garanci të madhe më dhënka neni 66/1, ku shkruajmë se

nëpunësi civil ka më shumë garanci?! Mua kjo nuk më duket garanci, por thjesht një propagandë. E shtojmë këtu, e kemi në Kushtetutë, por përsëri jemi të bindur se kur këto zonja t'i thërresim përsëri pas tre muajsh apo 5 muajsh dhe të bëjmë një diskutim për vendimet e formës së prerë të gjykatave që janë marrë gjatë viteve, se do të keni përsëri evidenca me njerëz që kanë vendim gjykate, por që nuk janë futur ende në punë. Prandaj kjo më duket hipokrizi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ky është një debat të cilin e iniciova edhe unë dje në funksion të nevojës për të pasur një qasje më pozitive ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkak të shqetësimeve që ka në praktikë. Unë jam një nga ata që kam pasur raste të më vijnë letra, ankesa, kërkesa nga qytetarë të moshave të ndryshme lidhur me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë. Kjo ka qenë një pyetje permanente që unë e kam bërë personalisht sa herë ka ardhur këtu gjatë kësaj legjislature zonja ministre ose drejtoresha për të raportuar. Kam marrë përgjigje për shqetësimin e tyre, por sot ishte momenti për të sqaruar diçka më shumë. Pa dyshim që Kushtetuta është një normë eprore mbi të gjitha ligjet e tjera, duke përfshirë edhe këtë ligj, por është shumë e nevojshme që ta qartësojmë atë në një dispozitë. Me këtë dispozitë ne mendoj se kemi zgjeruar rrethin e mundësisë për t'i sistemuar këta në punë. Kjo është një zgjidhje, në vlerësimin tim, pozitive. Sa efekt do të ketë, do të mbetet të provohet në praktikë. Edhe unë mund të kem pikëpyetjet e mia. Zoti Fino ishte më i drejtpërdrejtë në këtë pjesë, por le të mbetet ta shikojmë se çfarë efekti do të japë dhe ne jemi këtë për të parë se cili do të jetë rezultati i aplikimit të kësaj dispozite.

Dakord. Zoti Fino tha që ishte kundër.

Neni 10 i projektligjit nuk pranohet. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 11 i projektligjit i sjellë nga qeveria nuk pranohet. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 12 i projektligjit i sjellë nga qeveria nuk pranohet. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 13, që shfuqizonte pikën 1 të nenit 71, nuk pranohet. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 14 që parashikonte dy shtesa, nenin 71/1 dhe 71/2, nuk pranohet për shkak se është rregulluar edhe më lart. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 15 gjithashtu nuk pranohet, duke qenë se neni 16 i projektligjit e sqaron këtë plotësisht. A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 16 i projektligjit numërohet si neni 23 dhe nuk pëson ndryshime. Kjo do të thotë se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

A jeni dakord?

Milena Harito – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbylлим këtu me ndryshimet e bëra sipas projektit që është diskutuar, që është dakordësuar dhe që është miratuar këtu me ndryshimet që u bënë në nenin 1 të projektit që kemi përpara dhe në nenin 30, pika 5.

Dakord, më pas do ta votojmë në tërësi.

Zonja Ministre, do t'ju lutem që bashkë me drejtoreshën, e kam shumë seriozisht këtë gjë, që në një moment të përshtatshëm, sot ose nesër, t'i bëni një sqarim medias për të gjitha risitë dhe ndryshimet shumë pozitive që i janë bërë ligjit gjatë këtij debati këtu në konsultim me SIGMA-n, që e bëjnë ligjin më interesant dhe më eficient.

Faleminderit, zonja Ministre dhe zonja drejtoreshë për bashkëpunimin!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë””.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Erion Luçi – zëvendësministër i Financave

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancinë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë””.

Sot kemi të pranishëm dy zëvendësministrat e Financave, zotin Luçi dhe zotin Mete, për të paraqitur projektin dhe për të dhënë sqarime të mundshme lidhur me të.

Kush do ta prezantojë projektin nga ju?

Urdhëroni, zoti Luçi!

Erion Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Po e filloj me një shpjegim të përgjithshëm të parimit pse e kemi sjellë një ndryshim të tillë të ligjit.

Me ezaurimin e tregut të brendshëm bankar, sidomos gjatë dy vjetve të fundit, është bërë më emergjente nevoja e kalimit në tregjet ndërkombëtare. Ky do të ishte një zhvillim i natyrshëm që do të vinte me kalimin e kohës, por tani është edhe më emergjente, duke pasur parasysh mbivendosjen e madhe që ka qeveria ndaj tregut të brendshëm bankar, i cili në një kohë rigjenerimi të ekonomisë mund të shkaktojë edhe një ngushtim të hapësirës për kreditim të sektorit privat. Kështu që, duke dalë në tregjet ndërkombëtare, bëhet një lëvizje e nevojshme edhe për mbështetjen e tregut privat, por edhe për të menaxhuar më mirë likuiditetin e nevojshëm të qeverisë që miratohet çdo vit në ligjet e buxhetit në vend. Ligji aktual nuk bën një dallim të qartë ndërmjet marrëveshjeve dhe instrumenteve. Ne këtu po flasim për përdorimin më aktiv të instrumenteve të tregut që përcaktohen në përgjithësi nga tregu dhe jo nga marrëveshja paraprake që vjen për miratim në Kuvend. Për shembull, marrëveshje të tilla mund të jenë marrëveshjet që lidhen me Bankën Botërore, që negociohen nga ne dhe sillen të plota për miratim. Këto janë marrëveshje ndërmjet dy sovranëve. Ndërkohë, instrumentet e tregut përcaktohen ditën kur dalin në treg. Shumica e termave të tyre dalin në çastin kur këto instrumente dalin në treg, pra pak a shumë si bonot e thesarit të qeverisë në tregun e brendshëm, që përcaktohen çdo javë ose çdo muaj, kur ka ankande. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me instrumentet që ne lëshojmë në tregun ndërkombëtar. Këto janë thjesht instrumente në monedhë të huaj, por në thelb janë të njëjtat instrumente si bonot e thesarit që qeveria lëshon në tregun lokal. Eksperienca ka treguar se interpretimi i këtyre instrumenteve si marrëveshje është mjaft inefficent në aspektin e kapjes së momentit të duhur në treg dhe në aspektin e shkëmbimit të informacionit që i duhet Kuvendit.

Ndaj ne thjesht kemi bërë një saktësim më të qartë të ndarjes, sidomos për tregun ndërkombëtar, të instrumenteve nga marrëveshja. E thënë më thjesht, në çastin kur ne na jepet mundësia për të dalë, për shembull, në tregun e eurobondeve në Europë apo në Amerikë, në fillim të vitit që vjen, kjo do të ndodhë që ne shikojmë interesin më të mirë për të lëshuar këtë eurobond. Ndërkohë, procedurat që mund të kalojnë nëpërmjet parlamentit mund të duan të paktën tri muaj dhe vlera e shtuar, në aspektin e eficiencës, për marrjen e këtyre instrumenteve të kontrollit është pak a shumë e ezauruar nga ligjet e mëparshme të buxhetit, që përcakton saktësinë. Strategjia e borxhit përcakton saktësisht se si dhe sa borxh do të marrë qeveria gjatë një viti të caktuar përgjatë periudhës afatmesme.

Megjithatë unë mund t’ju jap një sqarim të mëtijshëm, përveç pjesës legale, nëse ka ndonjë element në aspektin ekonomik apo parimor të këtyre ndryshimeve, për t’ju sqaruar më mirë dhe më qartë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Ervin Mete – Nëse mundem për pjesën ligjore.

Sot Kushtetuta kërkon autorizim me ligj për pjesën e huamarrjes apo të buxhetit. Argumenti që ne japim dhe mendojmë se është i saktë dhe vjen në linjë edhe me eficiencën është që ky autorizim do të jepet dhe jepet sot nga parlamenti në ligjin vjetor të buxhetit, i cili përcakton masën e huamarrjes, shërbimin e borxhit, duke nënkuptuar në njëfarë mënyrë edhe kushtet me të cilat do të shlyhet ky borxh. Në ndryshimet që kemi bërë, apo ne qasjen që kemi tashmë miratohet një kuadër trevjeçar, pra në njëfarë mënyre miratohet jo vetëm vjetore, por edhe 3-vjeçare. Ky do të jetë autorizimi, së bashku me këtë ligj, që parlamenti i jep qeverisë për të menaxhuar hapësirën e borxhit, duke i kërkuar raportim të detajuar për të gjithë veprimtarinë e borxhit, por duke shmangur miratimin zë për zë të huamarrjes, këtu do të bëj klasifikimin, private.

Pra, në lëmin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti ynë paraqitet si sovran dhe hyn në marrëveshje me një shtet tjetër për marrëveshjet ndërkombëtare publike dhe për ato marrëveshje ndërkombëtare, që lidhen midis shtetit tonë dhe një organizate ndërkombëtare publike, subjekt i të drejtës ndërkombëtare, qartësisht këtu kemi të bëjmë me një “traktat”, i cili duhet të kalojë dhe të ratifikohet në parlament.

Pjesa e huamarrjes private, kjo është qasja e ligjit, ku dilet me instrumente në tregje, pra me bono, siç dilet brenda, ose me një eurobond, që mund të dilet edhe jashtë për shkak të monedhës, apo të kredive ku shteti operon në një kuadër privat, parlamenti jep autorizimin nëpërmjet ligjit të buxhetit dhe më pas kjo menaxhohet brenda kufijve të vendosura nga parlamenti, që nuk mund të tejkalohen nga qeveria, për t’iu përshtatur eficiencës së tregut dhe nevojës për të operuar me shpejtësi.

Dua të theksoj se kjo është një qasje dhe praktikë ndërkombëtare. Domethënë, pas viteve ’80 kështu kanë lëvizur të gjitha qeveritë sa më shumë që zhvillohen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Unë kam dy gjëra:

Së pari në Kushtetutë thuhet se huamarrja miratohet me ligj. Unë nuk e kuptoj dot paragrafin: “Ministri i Financave ka të drejtë të lidhë kontrata huamarrjeje shtetërore, apo të emetojë instrumente të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm për sa kohë respekton kushtet e përcaktuara në ligjin për buxhetin e shtetit”, pra për buxhetin vjetor përkatës. Vazhdon me tej: “Në rast se tejkalon kufizimin e ligjit të buxheti vjetor, miratimi bëhet nga Kuvendi”. Pra, ministrit të Financave i jepet mundësia të lidhë kontratë huamarrjeje brenda buxhetit të shtetit për huamarrjen, sa për qind është, por ministri mund ta firmosë edhe nëse e tejkalon atë, kështu thuhet në ligj, dhe më pas e sjell në parlament dhe ia ligjërojmë ne. Kjo mua nuk më duket korrekte në rastin konkret për të respektuar Kushtetutën, megjithëse aty thuhet se huamarrja miratohet me ligj dhe nuk mund ta bëjë kushdo, pavarësisht se quhet ministri i Financave.

Së dyti, te neni 9 thuhet: “Ministri i Financave emëron këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmjetësit financiarë të borxhit shtetëror”. Ndërkohë që kushtet dhe procedurat për emërimin e tyre i përcakton vendimi i Këshillit të Ministrave. Përderisa përcakton kushtet dhe procedurat, Këshilli i Ministrave le të caktojë edhe agjentët dhe të jemi në rregull. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Cili është reagimi i zëvendësministrave për të dyja komentet e zotit Fino?

Ervin Mete – Unë po jap përgjigje për pjesën ligjore, më pas zoti Luçi do të flasë për pjesën tjetër.

Kushtetuta, nenit të cilit i referoheni saktësisht, thotë: “Shteti mund të marrë dhe të garantojë hua dhe kredi financiare kur autorizohet me ligj”, jo kur miratohet. Argumenti është që autorizimi do të jepet me ligjin e buxhetit, pa kërkuar miratim të çdo instrumenti. Kjo është pika parë.

Pika e dytë, kufiri nuk mund të tejkalohet nga ministri në asnjë rast. Pra, kushtet dhe kufijtë në autorizim jepen vetëm nga parlamenti.

Nëse nuk ka dalë e qartë aty, do ta riformulojmë, por logjika e ligjit është kjo: në asnjë moment nuk mund të kalohet kufiri pa ardhur në parlament për ta diskutuar këtë kufi.

Për sa i përket menaxhimit të borxhit, të instrumenteve dhe daljes në treg për to, kjo edhe sot bëhet nga ministri i Financave. Për këtë pjesë zoti Luçi do të japë sqarimet e nevojshme.

Erion Luçi – Kushtetuta respektohet në çdo rast për sa kohë që parlamenti i jep të drejtë qeverisë që të marrë borxh deri në njëfarë pike. Aty lidhet me pjesën kufizuese të ligjit.

Në aspektin e menaxhimit të borxhit, ky është pak më dinamik si ekzekutim dhe është e vështirë që për çdo instrument të nxirret një ligj, sepse i bie që për çdo ankand bonosh thesari javor ose mujor që nxjerr qeveria të dalë një ligj. E njëjta gjë vlen edhe për instrumentet ndërkombëtare. Kështu që ne nuk shohim një kontradiktë me pjesën kushtetuese, ku thuhet se huamarrja vendoset me ligj, që është pak a shumë brenda kuadrit të ligjit të buxhetit. Ndërkohë që këtu po diskutojmë për ekzekutimin e kësaj të drejte që i jep parlamenti me ligj Ministrisë së Financave ose qeverisë.

Për sa u përket agentëve, diskutohet që rregulloret miratohen në një mënyrë jo frekvente se sa dalja dhe përzgjedhja e agentëve. Domethënë, ne përsëri mund ta dërgojmë edhe në një nivel vendimmarrje në Këshillin e Ministrave zgjedhjen e agentit, por ideja është që rregullat zgjidhen në një nivel më të lartë të mënyrës sesi përzgjidhet agjenti dhe më pas agjenti mund të zgjidhet në mënyrë më të shpeshtë nga ministri i Financave, duke pasur parasysh të njëjtën logjikë të frekuencës së daljes në treg. Nëse neve na duhet ta dalim në treg çdo muaj, do të ishte inefficente që për çdo gjë të dërgohet një miratim në nivel qeverie.

Krahasimi me bonot e thesarit është e njëjta gjë. Për shembull në rastin e Shqipërisë agjenti është Banka e Shqipërisë dhe ne atë e kemi marrë një herë si vendim dhe gjithmonë e marrim si të mirëqenë që do të vazhdojmë të mbajmë Bankën e Shqipërisë. E njëjta gjë ndodh edhe për agentët ndërkombëtarë, pasi zgjidhet një bankë e caktuar. Ti mund ta përdorësh bankën

edhe për të bërë veprime të ndryshme nëse marrëdhëniet dhe eficientia e daljes në treg është e kënaqshme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Kam edhe unë një pyetje.

Buxheti jep borxhin që i krijohet në një vit, apo nivelin e borxhit në tërësi?

Erion Luçi – Buxheti i një viti parashikon vetëm huamarrjen e re të një viti pasardhës. Ndërkohë që në një nen të buxhetit përcaktohet edhe niveli i borxhit që do të arrihet për vitin që vjen.

Ne jemi në proces për të futur edhe një rregull fiskal pak a shumë si ai që ka qenë, që e kufizonte edhe borxhin publik brenda 60% të PBB-së, e cila do ta përcaktojme më saktë pjesën e kontrollit afatgjatë të nivelit të borxhit që duhet të mbajë qeveria.

Këtë vit në parlament është sjellë një buxhet 3-vjeçar, nuk është thjesht 1-vjeçar.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Parlamenti nuk ka miratuar buxhet 3-vjeçar, por një vit fiskal.

Erion Luçi – Janë miratuar gati 3 vjet me tavanet që janë futur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pyetje të tjera? Zoti Majko, keni fjalën.

Pandeli Majko – Unë kam dy pyetje:

Me sa kuptova, ju po përpiqeni të na shpjegoni nëpërmjet projektligjit të ardhur se ju duhet një fleksibilitet apo një eficientë në mënyrën sesi qeveria do të lëvizë në tregun privat për gjetjen e kredive. Koha që i duhet me procedurën ekzistuese është thuajse e pamjaftueshme që ju të jeni eficientë për të gjetur kredinë më të mirë me interesin më të ulët. Do t'ju lutesha të na e pohoni me po ose jo, sepse është e nevojshme që unë ta kem saktë këtë gjë.

Erion Luçi – Kjo është e saktë.

Ideja është që të rritet fleksibiliteti për gjetjen e një momenti më të saktë për të hyrë në marrëdhënie me tregun, sepse tregu ka një vullativitet goxha të lartë. Në eksperiencën e fundit u tregua që nga kjo vonesë tregu u mbyll dhe qeveria u detyrua të nxirrte një kredi sindikale me pasoja që pati.

Pandeli Majko – Pyetja tjetër që rrjedh nga kjo është: nëpërmjet këtij projektligji që keni sjellë sot në terma realë ju kërkon autorizim pa limit nga Kuvendi i Shqipërisë për marrje borxhesh?

Në nenin 156 që ju cituat thuhet: “Shteti mund të marrë dhe të garantojë hua dhe kredi financiare kur autorizohet me ligj”. Duke qenë se unë jam i vetmi anëtar i komisionit të Kushtetutës, i mbijetuar në Komisionin e Ligjeve, dua t’ju pyes: si e interpretoni këtë fjali dhe nen të Kushtetutës? Dua t’ju tërheq vëmendjen në faktin që fjalia fillon me “Shteti mund të marrë kredi ose...”, jo qeveria. A mund të më bëni një interpretim më të thellë në lidhje me këtë çështje?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Urdhëroni!

Ervin Mete – Së pari, jo autorizim pa limit. Domethënë, qartësisht limitet përcaktohen në ligjin e buxhetit, qoftë sa do të jetë limiti, qoftë edhe pjesa e shërbimit të borxhit. Pikërisht ky është autorizimi që kërkohej. Nëpërmjet këtij ligji përcaktohen procedurat sesi merret huaja, qoftë kjo nëpërmjet kredive private, sepse vetëm për pjesën private po flasim, qoftë nëpërmjet instrumenteve, që nuk janë marrëveshje të shkruara, prandaj bëhen edhe ndryshimet, në sensin klasik të fjalës, por është një dalje në treg.

Për sa i përket nenit 156, edhe sot ministri i Financave, me plotfuqishmërinë që merr nga Presidenti apo nga Këshilli i Ministrave, nënshkruan marrëveshje. Kjo plotfuqishmëri, pra e gjithë procedura që, në fakt, rregullohet me ligjin e traktateve ose me procedurë të veçantë, do të mbetet.

Sot shteti, në mënyrën sesi është formuluar këtu, merr qoftë në emër të Republikës, qoftë në emër të qeverisë, sepse një farë mënyre të dyja janë shtet.

Fatmir Xhafaj – Kjo ishte përgjigjja për të tria pyetjet? Në rregull.

Më fal, besoj se jua kanë thënë se jo çdo gjë që vjen nga qeveria mund të miratohet, duhen argumente. Ne nuk jemi komision përgjegjës, komision përgjegjës është ai i Ekonomisë, por për mendim e kemi dhe mos e merrni me të qeshur mendjen tonë.

Pyetje të tjera?

Zoti Subashi, keni fjalën.

Armando Subashi – Në fakt, edhe unë këto do ta filloja, që ne nuk jemi komision përgjegjës, por për dhënie mendimi. Sigurisht, aty ku ka të bëjë me Kushtetutën projektligji q

ë vjen këtu vëmendja jo është maksimale. Besoj se ky është fokusi kryesor, për të mos thënë i vetmi.

Pa dyshim neni 156 i Kushtetutës parashikon atë që u tha këtu dhe mbi këtë bazë unë kam këto pyetje:

Së pari, kjo që thuhet në Kushtetutë: “Marrja e huave duhet të autorizohet me ligj”, sipas pikëpamjes suaj, presupozon se duhet të bëhet rast pas rasti? Pra, sa herë që shteti shqiptar duhet të hyjë në një marrëdhënie të caktuar borxhi apo detyrimesh financiare, ose më saktë kredish financiare, duhet të kërkohet autorizim me ligj rast pas rasti, apo është e mjaftueshme ajo që jepet një herë në vit me ligjin për buxhetin e shtetit?

Së dyti, nëse do të pranojmë këtë logjikë, që kjo jepet një herë në vit me ligjin e buxhetit të shtetit, a është i mjaftueshëm ky lloj autorizimi vetëm për sasinë e borxhit? A ka të drejtë ligjvënësi, pra ai që nxjerr ligjin, në rastin konkret Kuvendi, të dijë diçka më shumë edhe për efikasitetin e borxhit? Nëse do të thoshim se Kuvendi i thotë qeverisë se ti mund të marrësh borxh 500 milionë euro dhe me kaq e kryen detyrën e tij, mendoj se Kuvendi duhet të dijë jo vetëm sasinë, që duhet të marrësh 500 milionë euro borxh për vitin, supozojmë vitin që vjen, por Kuvendi duhet të dijë edhe se si do të merret ky borxh, me çfarë interesash, me çfarë afati shlyerjeje, sa do të rëndojë e gjithë kjo histori në vitet që vijnë më pas e kështu me radhë. Pra, mendoni që ky është edhe koncepti juaj apo unë e kam gabim pyetjen dhe Kuvendi duhet të mjaftohet vetëm me kaq, mjafton t’i thotë qeverisë: “Merr këtë sasi borxhi dhe je në rregull dhe e ke përmbushur detyrimin kundrejt Kushtetutës dhe kundrejt ligjit!”?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Zoti Luçi, keni fjalën!

Erjon Luçi – Në fakt, kjo lloj dhënie të drejte për të ngritur borxhin, kontrollon pikësëpari, edhe nivelin e përgjithshëm të borxhit, sepse po të miratohet një deficit nën kontroll, edhe borxhi do të mbetet nën kontroll, por ka, gjithashtu, edhe disa elemente të tjera në ligjin e borxhit, që e detyrojnë qeverinë të raportojë në parlament për të miratuar strategjinë e borxhit, performancën e borxhit, duke përfshirë edhe instrumentet dhe mënyrën, si është menaxhuar gjatë vitit të kaluar borxhi. Neni 6 i ligjit të menaxhimit të borxhit e bën pikërisht këtë. Aty thuhet

qartësisht: “Ministria e Financave raporton në parlament për mënyrën sesi është menaxhuar borxhi gjatë vitit pak a shumë, njësoj me mënyrën sesi raportohet edhe ekzekutimi i buxhetit”.

Bëhet në fillim një sqarim në miratimin e buxhetit në nëntor, (siç u bë këtë vit). Ka një pjesë shumë të detajuar të mënyrës sesi mendohet dhe si planifikohet menaxhimi i borxhit vitin që vjen, duke përfshirë edhe instrumentet që mendohen për të përmbushur nevojat për likuiditete dhe nevojat e deficitit. E njëjta gjë ndodh edhe në çastin e buxhetit faktik. Është neni 63, pika “c”, që përcakton saktë këtë dhe ku thuhet: pjesa e menaxhimit të borxhit raportohet në aspektin e performancës, që sapo e përmendët ju.

Në ligjin e ri organik, të cilin mendojmë ta propozojmë vitin e ardhshëm, mund të detajohet më shumë, sidomos pjesa e raportimit për buxhetin faktik, sidomos në aspektin se çfarë mund të raportohet në Kuvend, në aspektin e menaxhimit të borxhit, gjë që bëhet aktualisht, por mund të strukturohet më mirë në ligj. Kështu që, pjesa e dhënies së të drejtës për të ngritur marrjen e borxhit, kompensohet me përmirësimin e monitorimit të performancës që i bëhet menaxhimit të borxhit, nëpërmjet ligjeve ekzistuese, por edhe shtesave që mund t’u bëhen këtyre ligjeve ekzistuese, në aspektin e raportimit më të detajuar.

Armando Subashi – Ju thoni: në fund të vitit buxhetor. Pra, mbasi është marrë borxhi, mbasi qeveria ka marrë borxhin ka lidhur marrëveshjet me interesa me afate dhe me instrumente...

Erjon Luçi – Është edhe në fillim të vitit raporti.

Armando Subashi – Ti s’vjen më për të raportuar, sepse e ke marrë autorizimin, është miratuar ligji për buxhetin dhe që nga 1 janari, qeveria fillon ekzekutimin e atij ligji.

Erjon Luçi – Te relacioni i buxhetit është një pjesë shumë e gjatë dhe e detajuar për mënyrën sesi do të ngrihet dhe do të menaxhohet borxhi për vitin tjetër me instrumente në tregun e brendshëm, me instrumente të huaja. Përmendet edhe pjesa e marrëveshjeve të pritshme, që planifikohen për vitin tjetër. Megjithatë, marrëveshjet ratifikohen në parlament, sepse kështu e kërkon Kushtetuta dhe është një pjesë që është lënë jashtë kësaj.

Megjithatë, ne po diskutojmë atë pjesë të instrumenteve, që qeveria i nxjerr në treg, të cilat, e ritheksoj, janë shumë të rregullta (e ritheksoj), janë bonot e thesarit që dalin çdo javë. Megjithatë, është edhe paraprakisht për shembull, pjesa e buxhetit që u miratua këtë vit për borxhin, është shumë e detajuar, ndoshta në disa aspekte, është e mbidetajuar në aspektin teknik.

Armando Subashi – Nga shpjegimi që sapo dhatë, ideja është që ligji që keni sjellë prek vetëm borxhin e jashtëm në raport me subjekte private. Këtu kërkon dorë të lirë qeveria? Po në raport me institucione të njohura ndërkombëtarisht siç mund të jenë BB-ja, FMN-ja a kërkohet procedurë ekstra, apo jo?

Erjon Luçi – Jo, ajo procedurë mbetet siç është.

Armando Subashi – Po ku është dallimi midis FMN-së apo BB-së dhe një banke private?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Erjon Luçi – Shpjegimi komercial sapo u përmend, por është edhe shpjegimi legal; këto janë subjekte të së drejtës ndërkombëtare publike, që edhe ato vetë kërkojnë një ratifikim në parlament, por në aspektin praktik, për shembull me FMN-në, marrëveshja negociohet kohë më përpara se të vijë në parlament dhe ne i kemi të përcaktuara gati të gjitha termat. Kur vijmë këtu jemi të sigurt që asgjë s’do të ndryshojë pasi të marrim miratimin. Pak a shumë edhe fjalët “ratifikim i parlamentit”, do të thonë që miratohet diçka, për të cilën është marrë vendimi.

Në rastin e tregut, është një vendim që merret pa palën e tretë që do ta marrë atë si instrument dhe që nuk firmos asgjëkund, ajo thjesht, do ta blejë instrumentin, siç blihen bonot e thesarit duke firmosur thjesht në llogari, por jo bonot e thesarit dhe në këtë rast, eurobondin do ta marrë një vizitor, i cili mund të jetë kushdo në treg. Ardhja në parlament për të thënë që na duhet për t’ia shitur këtij investitori është disi e pakuptimtë, në aspektin praktik.

Një çështje tjetër, të cilën e kemi konsultuar me eksperiencat ndërkombëtare, së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë, është një eksperiencë e zakonshme për të gjitha vendet e botës (hiq vendet në zhvillim ose vendet pak të zhvilluara). Eksperiencat e miratimit nga parlamenti të çdo instrumenti vazhdojnë të ekzistojnë vetëm në disa vende të Afrikës. Shumica e vendeve të Europës dhe shumica e vendeve të tjera të Azisë dhe të Amerikës, kanë fleksibilitetin e nxjerrjes së instrumenteve nga tregjet ndërkombëtare në të njëjtën mënyrë, siç janë në tregjet lokale.

Megjithatë, e ritheksoj, se kjo vjen si pasojë e rritjes së monitorimit dhe raportimit të performancës për strategjinë e borxhit, që dorëzohet çdo vit në parlament dhe vjen si pjesë e buxhetit vjetor dhe kalon përtej buxhetit vjetor, sepse strategjia e borxhit është pak më e gjatë dhe e performancës pasi është menaxhuar borxhi i vitit. Po të shikoni, ka një pjesë të shpjegimi

i borxhit, që shpjegon se përse është devijuar nga ajo që u tha në fillim të vitit. Për shembull, në rastin që po flasim tregu i brendshëm mund të jetë pak më aktiv sesa tregu i jashtëm dhe ndodh natyrshëm një zhvendosje nga instrumentet e brendshëm, në instrumentet e jashtëm. Kjo nuk mund të parashikohet në çdo moment në fillim të vitit, po është një lëvizje normale që mund të ndodhë në mes të vitit për të zhvendosur më shumë instrumentet e huaja brenda të njëjtëve parametra risku dhe të njëjtëve parametra sasiore, që përcakton parlamenti.

Po marr edhe një shembull tjetër: nëse themi që qeveria rrit papritur instrumentet me risk apo rrit papritur sasinë e borxhit, që mund të tregojnë një farë zhvendosjeje nga trajektorja e borxhit që parlamenti do të ketë nën kontroll, gjithmonë ekziston viti pasardhës ose pjesa tjetër e diskutimeve, ku mund të thuhet hapur (në këtë rast nuk është thjesht ky komision, por është edhe ai i Ekonomisë), që tregon që me këtë strategji ju do të kapni, për shembull: objektivat e borxhit poshtë 60 -përqindëshit, brenda vitit 2020.

Shpërthimi apo kontrolli i borxhit nuk ndodh brenda 1 viti. Po të shikoni, rritja e borxhit gjatë viteve të kaluara u bë në disa vite. Kontrolli nga ana e parlamentit është goxha i mundshëm, në aspektin e kontrollit të strategjisë në mënyrë vjetore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush ka pyetje të tjera?

S’ka pyetje të tjera.

Zoti Fino, keni fjalën!

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Në këtë orë ia vlen të mësojmë nga njëri-tjetri. Mund të japim ndonjë zgjidhje, mund të japim ndonjë ide, por mundet edhe të kuptojmë, se çfarë do të bëhet në të ardhmen. Jo çdo gjë që vjen nga qeveria, miratohet.

Nga pyetjet dhe diskutimet do të thosha se ky projektligj është i domosdoshëm, por projektligji mund të goditet në Gjykatën Kushtetuese pikërisht për këtë që thashë. Mundet që Gjykata Kushtetuese ta shpallë në rregull dhe mund të vazhdohet.

Nga ajo që dëgjova nga zëvendësministrat, të cilët i falënderoj për performancën e tyre, kuptova se këtu bëhet fjalë për të përfutur kohë në negociata, në normat e interesit, kur marrim kredi dhe natyrisht, e kanë shumë vende përparimtare, si Amerika e të tjera, ndërkohë,

shumë vende në zhvillim ose vendet pak të zhvilluara si Afrika dhe i bie që dhe ne, të jemi pjesë e tyre, duke pasur nenin 156 të Kushtetutës.

Problemi është shumë më i thellë (e konsultova edhe me kolegun tim, Peza).

Në fakt në Kushtetutën e kohës së monizmit, nuk e kishim huamarrjen, s'mund të merrnim dot hua. Në Kushtetutën që bëmë (e tha shumë mirë Pandi), vumë një nen për të treguar që do të marrim hua, pra, nuk jemi vend komunist, por huan që do të marrim, do ta kontrollojmë, se s'mund të marrim hua, pa asnjë lloj kontrolli. Në momentin që e kemi vënë te neni 156 që të mund ta kontrollojmë, na lini mundësi ta kontrollojmë ose duhet të abrogojmë nenin 156, që ta lëmë të hapur (jo komunizëm), por qeveria të negociojë të marrë hua, pa ardhur fare në parlament.

Natyrisht, çdo vit miratohet buxheti dhe njëkohësisht miratohet borxhi i jashtëm apo i brendshëm dhe në rastin konkret, është e kontrollueshme. Kështu që këto janë diskutime për një auditor më të gjerë dhe me një juri shumë të specializuar, që mund ta diskutojë këtë çështje edhe nga kjo pikëpamje, prandaj pyeta: po në rast se tejkalon kufizimet e ligjit për buxhetin vjetor, përse duhet t'ia miratojë buxheti atë që firmos ministri i Financave?

Ju kështu e keni shkruar: "Ministri i Financave ka të drejtë të lidhë kontrata huamarrjeje shtetërore, instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm, për sa kohë respekton kushtet e përcaktuara në ligjet për buxhetin".

Ne kemi përcaktuar borxhin për shembull 70%, aq sa është borxhi në këto momente. Pasi e miratuam këtë, ai ka të drejtë të hedhë firmën për këtë lloj borxhi. Po nëse ai e tejkalon këtë lloj borxhi dhe pastaj vjen e na thotë: meqë e ka neni 156, meqë e ka edhe ky projektligj, ma miratoni pak rritjen e borxhit nga 70% të GDP-së, në 75% të GDP-së? Ne jemi të detyruar të ngremë dorën dhe ta miratojmë, sepse e përmban neni 156 që ta miratojmë këtë shifër.

Kjo bie ndesh dhe mund të jetë një barrierë, që s'të lejon të veprosh lirshëm, por janë kushtet e nenit 156 të Kushtetutës, që s'e lejojnë një gjë të tillë.

Zoti Kryetar, siç duket, pavarësisht diskutimeve që u bënë këtu, unë s'pretendoj se kam bërë ndonjë diskutim të artë (diskutim më të specializuar mund të bëni ju si juristë), ne mund ta kalojmë projektligjin, por natyrisht, mund të ketë shumë njerëz që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (mund edhe të mos ketë), dhe nuk e di sesa do të mund t'u vijmë realisht në

ndihmë qeverisë dhe Ministrisë së Financave, për të zgjidhur këtë problem, të cilin e shpjegoi shumë mirë zëvendësministri, që e kanë shumë vende të zhvilluara, siç e ka Amerika dhe nuk marrin në konsideratë këtë kufi, që e lejon Kushtetuta jonë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Kush ka pyetje të tjera?

Zoti Majko, keni fjalën!

Pandeli Majko – Unë do ta filloja nga fakti që qeveria ka ardhur t'i kërkojë ndihmë parlamentit që në një treg shumë të komplikuar dhe në kushte krize të ketë fleksibilitet sa më maksimal, me qëllim që gjithë periudha e konsumimit të procedurës burokratike që njeh e gjithë precedenca kushtetuese dhe ligjore në Shqipëri, që nga viti 1998, domethënë për 15-16 vjet, borxhi në Shqipëri ka njohur një procedurë standarde në Kushtetutë dhe në ligj, gjë që do të thotë se gjithmonë është bërë me autorizimin e Kuvendit.

Tani kemi një situatë të tillë të ndërlikuar tregtare dhe në thelb mendoj se ky nuk është vetëm një diskutim projektligji, por edhe një diskutim me dyer të hapura lidhur me faktin se sa eficiente do të jetë qeveria në tregun e biznesit privat të marrjes së kredive. Unë mendoj se hapësira për të diskutuar sesi mund të jetë procedura në mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase nëpërmjet këtij autorizimi ose jo, është një debat shumë i gjerë dhe teknik që mbase do të kërkojë një ekspertizë të caktuar. Unë e vlerësoj shumë mënyrën, sesi kërkuan ta mbrojnë projektligjin të dy zëvendësministrat. Në radhë të parë u përpoqa të kuptoj shqetësimin e qeverisë që ata sollën këtu, për të qenë sa më efikas në tregun e marrjes së kredive.

Të them të drejtën, kam dy shqetësime:

I pari, ka të bëjë me faktin nëse mund të ekzistojë një mekanizëm tjetër, që të ndihmojë qoftë qeverinë, qoftë Ministrinë e Financave, lidhur me marrjen e borxhit dhe me efikasitetin, qoftë edhe nëpërmjet procedurës që njohin Kushtetuta dhe ligji deri tani. Flas nga viti 1998-2014. Me Kushtetutë i është njohur e drejta qeverisë që për aktet, të cilat kërkojnë një procedurë shumë të shpejtë, jashtë konteksteve normale burokratike, është e drejta e vendimmarrjes me akt normativ, i cili është një akt me fuqi ligjore, i cili vazhdon deri në 6 muaj.

Unë nuk e di dhe nuk e kam kontestim, por në vazhdim të këtij diskutimi shumë të nevojshëm (ne jemi komision për dhënie mendimi, pasi komision përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë), nuk e di sa efikase do të ishte një mënyrë tjetër e të parit të problemit në funksion

të efikasitetit të procedurave, pra, t'i njihej qeverisë e drejta e akteve normative për të tilla raste dhe mbase me një ligj të veçantë, të miratohej një procedurë që të vihej parlamenti para disa detyrimeve të shpejtësisë së vendimmarrjes së tij, sesa të merrnim përsipër të ndërtonim një autorizim të përgjithshëm, për një qeveri dhe për një parlament me mandat të kufizuar.

Sado të përpiqemi të diskutojmë autorizimet që mund të japim si Kuvend, e kemi mandatin 4-vjeçar, ku një vit e ca, e kemi konsumuar. Ky është një problem i një natyre tjetër.

Ana tjetër për të cilën dua të flas hapur, është se ligjet bëhen për rastin më të mirë apo sjelljen më të mirë. Ligji duhet të marrë parasysh edhe sjelljen e keqe. Dua të sjell shembullin që ka qeverisja aktuale me borxhin e vjetër.

Borxhi i vjetër gati 700 milion e ca dollarë, që është një gjyle në këmbën e qeverisë aktuale, është rezultat i sjelljes së papërgjegjshme të qeverisjes së kaluar me borxhin dhe me marrjen e borxheve. Në mos gaboj, pas largimit të FMN-së nga Shqipëria që ishte kapistalli i vetëm për historinë e marrjes së borxhit, ne rrëshqitëm si lopa në jonxhë (s'desha ta përdor këtë shprehje), por pak a shumë kështu ishte sjellja e qeverisjes së kaluar, në lidhje me borxhin.

Përse dhe si? Shumë shkurt: qeverisjet kanë interesa politike. Kushtetuta thotë: "Shteti (jo qeveria) merr borxhe me autorizim". Kjo është një çështje që duhet ta diskutojmë. Ju vini në emër të qëllimit më të mirë të mundshëm dhe për këtë pikë s'ka nevojë të dyshohet, për një arsye shumë të thjeshtë: jemi një qeverisje që po vuajmë pasojat e keqmarrjes dhe keqmenaxhimit të borxhit nga qeverisja e mëparshme, prandaj sinqerisht, mund t'i bija shumë shkurt me pyetjen: a po shkelim Kushtetutën me këtë projektligj? Të them të drejtën, dua të jem edhe nën lëkurën e përfaqësuesve të qeverisë që po e hapin këtë diskutim. Kemi hyrë në zonën gri të ligjit, të Kushtetutës dhe kam frikë se mund të hedhim ndonjë hap tjetër më tutje, prandaj e mora fjalën, pikërisht për të bërë pyetjen qartë: a po shkelim apo jo Kushtetutën?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë koleg tjetër?

Po, zoti Peza.

Dashamir Peza – Ne kemi ndjekur një praktikë tjetër. Këto diskutime të kësaj natyre që bëmë, ia kemi lënë Komisionit të Ekonomisë t'i shterojë. Ne jemi marrë me një aspekt tjetër. Bie dakord me shqetësimin e të gjithëve që nevoja për kontroll është një nga detyrat shumë të rëndësishme që ka parlamenti për të parë sesi funksionojnë financat e vendit. Ne jemi dëshmitarë

që qeveria e shkuar e pati kaluar 60% -shin që e kishte me kufizim ligjor, madje erdhi e aprovoi pasi e kishte kaluar me kohë kufirin e borxhit.

Mendoj se është shumë e rëndësishme të ndërtojmë instrumentet e kontrollit, por a është e domosdoshme që ne t'i themi qeverisë, që kjo është e vetmja rrugë dhe mënyra sesi mund ta kontrollojmë qeverinë vetëm duke e aprovuar paraprakisht, apo ka instrumente të tjerë monitorimi, kontrolli, raportimi që mund ta zgjidhin këtë problem? Kjo është dilema. Ky është opinionimi im.

Fatmir Xhafaj – Kam një pyetje, kërkoj ndjesë, sepse dua të bëj pastaj një përmbledhje të kolegëve dhe të shfaq edhe mendimin tim. Ju çmuat se është e domosdoshme për të bërë një gjë të tillë për shkak të fleksibilitetit të tregut, të nevojës që qeveria të operojë me instrumente financiare në mënyrë të shpejtë që ta mundësojnë atë për të marrë hua me interesa sa më të ulëta. Kjo ishte pak a shumë ajo që thamë. Pra, të kapim momentin kur ajo është në pikën më të ulët të saj. Pyetja që kam unë: sa është afërsisht kjo kohë që do t'ju duhet juve për të operuar në treg? Një javë, dhjetë ditë, një muaj, të keni mundësi edhe pa pasur miratimin e parlamentit në momentin e parë, të dilni në treg?

Erjon Luçi - Në përgjithësi nuk është thjesht pjesa e momentit më të mirë të tregut, për shembull tani që flasim është një moment i mirë për të dalë në treg. Kërkesat që duhet të kalojmë për të dalë në treg, për shembull na duhen, të paktën tre muaj për të kaluar këtë cikël. Dalja në treg mund të duhet edhe për nevoja likuiditeti. Buxheti është jo thjesht marrje borxhi, por edhe shpenzime. Nëse shpenzimet në një çast të caktuar ecin pak më shpejt, unë do të kem nevojë t'i përballojë ato duke ngritur likuiditetin e mjaftueshëm për të bërë shpenzime. Nëse një investim i caktuar ecën më shpejt që është gjë e mirë, mua do të më duhet të marr likuiditetin e mjaftueshëm. Nëse këtë nuk ma siguron tregu i brendshëm, ndërkohë që kontraktori pret për ta marrë atë në kohë, më duhet të shkojë në një treg të jashtëm.

Ideja e pritjes ose e kalimit të këtyre proceseve ka edhe rrezikshmërinë e zgjatjeve për pjesën e shërbimeve financiare të lidhura me emetimin e instrumenteve që mund të dështojnë për arsye të ndryshme. Kohëzgjatja mund të shkojë 3-4 muaj që është shumë e gjatë për nevojën gati imediate që duhet ndonjëherë brenda javës apo dy javëve për të ngritur...

Fatmir Xhafaj - Argumenti kryesor që jepni, që e mbroini me sa kuptoj: jo e ka Bullgaria, jo e kanë disa vende në zhvillim, kjo është për ta mbushur me kontorno, mund ta ketë

ose jo një shtet por varet se çfarë kanë të shkruar në Kushtetutë, pra nëse është kufi kushtetues. Ne nuk po themi se mund të mos e ketë, se nuk ka praktika të tilla, i ka Amerika, i ka Gjermania, i ka Franca, por jam i bindur se nëse do të kishte kufizime kushtetuese, ata do të mendoheshin gjatë. Në një rast të tillë mund të ndryshosh Kushtetutën. Argumenti juaj i fortë është nevoja, domosdoshmëria për të qenë fleksibël në treg. Me procedurën parlamentare juve ju duhen 3-4 muaj apo jo? Nëse nuk do të kishit procedurën parlamentare dhe do të ishit në lirinë tuaj të plotë, pa dyshim do të nxirrnit një akt, një urdhër, një vendim të Këshillit të Ministrave apo e kam gabim? Sa kohë do t'u marrë kjo gjë?

Erjon Luçi -Kjo mund të bëhet gati brenda një apo dy javësh.

Kam edhe diçka tjetër. Po diskutojmë për tregje që janë shumë më të mëdha sesa Shqipëria dhe janë shumë kompetitive. Po flasim për agjentë që janë me reputacion të fortë.

Fatmir Xhafaj – Të bëjmë një debat të shpejtë. Ajo që kuptoj unë është që nëse këtë instrument do ta keni të kornizuar siç është sot që do të kalojë në procedurat parlamentare e kështu me radhë, kjo mund t'u marrë 3-4 muaj, nëse ju do të kishit këtë liri që të veproni me vendime, me aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave të deleguara nga ky ligj që rrjedhin në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, për të operuar, do t'ju duheshin 2-3 javë. Kjo është përgjigja?

Erjon Luçi -Po!

Fatmir Xhafaj - Ndajmë të njëjtin mendim?

Erjon Luçi -Po.

Fatmir Xhafaj- Besoj se ndaj të njëjtin shqetësim me kolegët se qëllimi është i mirë dhe pozitiv. Ajo që po demonstroi qeveria shkon në mbrojtje dhe në mbështetje të kësaj nisme, por ne nuk bëjmë një ligj që është për një qeveri, për një kryeministër apo ministër që kemi sot, që ishte dje apo mund të jetë nesër. Ne bëjmë një ligj që ka të bëjë me financat e shtetit dhe duhet të jetë një ligj i qëndrueshëm, siç kërkohen të jenë edhe vetë financat e shtetit. Ne bëjmë një ligj që ka të bëjë me përgjegjësitë e shtetit, të cilat duhet të jenë të qëndrueshme siç është roli dhe përgjegjësia që ka shteti. Ne bëjmë një ligj që duhet të rregullojë marrëdhënie të ndërmjet përgjegjësisë që ka parlamenti dhe asaj që ka qeveria në këtë proces në funksion dhe në interes të vendit, të ekonomisë dhe të publikut, por veprojmë në një kuadër kushtetues të caktuar, të cilin duhet ta respektojmë në frymë dhe në gjuhë. Kushtetuta ka disa nene, të cilat krijojnë pak probleme me këtë gjë që thoni dhe duhet një trajtim shumë i kujdesshëm. Si neni

156, ashtu edhe ai 121 kanë përcaktuar një kornizë që do një interpretim të kujdesshëm dhe t'i japim mundësinë qeverisë të jetë më fleksibël në funksion të realizimit të nevojës dhe interesit publik, sepse interesi publik është që të kemi mundësi të marrim hua me sa më pak kosto, me interes sa më të vogël dhe të paguajmë sa më pak detyrime, borxhe për nesër. Nuk është thjesht e bukur, por është nevojë, është një qëllim që duhet ta synojmë. Jam i bindur se qeveria synon në tratativa normale, por që ta bëjë atë më eficiente, e ka të domosdoshme të ketë disa instrumente më vepruese, që i japim më shumë liri dhe me shumë hapësirë. Kjo do të kërkojë të mos bie ndesh me përgjegjësinë që ka ajo në raport me qytetarin, me ligjvënësin dhe me Kushtetutën. Këtë çështje duhet ta trajtojmë me kujdes. Pjesët e tjera të këtij nenin janë të diskutueshme. Kjo është një pikë që merr diskutim, siç doli edhe këtu: ka pro, ka edhe jo kundër, nuk kishte kundër në një sens, por kishte hezitues apo që ngritën pikëpyetje sesi mund të bëhet në këto rrethana. Duke qenë se është një çështje e diskutueshme, ne mendojmë se ka edhe ndonjë zgjidhje brenda vetë Kushtetutës, por do të na duhet pak kohë që ta diskutojmë, të bëjmë edhe ndonjë konsultë me ekspertë të kësaj fushe që janë më të zotët sesa ne, jo thjesht si politikanë, por si profesionistë. Pra, një konsultë e kemi edhe ne të nevojshme. Mendoj se ka diçka në hapësirat e tjera të Kushtetutës që mund të interpretojmë. Ta lëmë, t'i japim mundësi që qeveria të ketë fleksibilitetin e nevojshëm dhe të ruajë përgjegjësinë që ka parlamenti për financat e shtetit. Kjo është shumë e rëndësishme dhe mund të gjejmë një zgjidhje që t'i mbajë të dyja këto. Kjo do të ishte një gjë shumë e mirë. Në fund të fundit realizon qëndrimin që ka qeveria dhe do ta linte parlamentin në rolin që ai ka aktualisht.

E mbyllim këtu. Nga kolegët u shtrua nevoja për të bërë një konsultë, por edhe unë e kam të domosdoshme të sqarojmë disa pikëpyetje që na dolën gjatë debatit, por edhe për shkak të kuorumit, nuk votojmë dot në parim. Do të lëmë një mbledhje në një nga 2-3 ditët e ardhshme për t'i dhënë zgjidhje. Komisioni përgjegjës që është Komisioni i Ekonomisë, duhet të marrë të gjithë përgjegjësinë e nevojshme për të vendosur para kalimit të projektligjit në seancë plenare.

Faleminderit, zotërinj zëvendësministra!

Ju falënderoj për sqarimet, mbështetjen, argumentet që dhatë, por na jepni kohën e nevojshme për të dhënë vendimmarrjen që ne e çmojmë si komision.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendimi për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Dashamir Peza, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Besnik Dervishi – komisioner i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe për të Drejtën e Informimit.

Vilma Çausholli – përfaqësuese nga Ministria e Financave

Fatmir Xhafaj -Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Kemi Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Informimin Publik për strukturën e re. Besoj se e keni të gjithë përpara.

Do të shqyrtojmë strukturën e re të paraqitur nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Informimin Publik. Ka qenë e domosdoshme paraqitja e një strukture të re për shkak të një përgjegjësie të re, jo thjesht në emërtim, por edhe në substancë të punës së komisionerit, gjë që e bën të domosdoshme nevojën për ta ristrukturuar në funksion të këtyre kompetencave ose përgjegjësi të reja që i ka dhënë Kuvendi këtij institucioni me qëllim për ta përshtatur me këto përgjegjësi dhe për ta bërë atë më eficient.

Zoti Besnik Dervishi është prezent në cilësinë e Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili do të na bëjë një paraqitje të përmbledhur.

Kolegët, nëse kanë pyetje, do t'i bëjnë ato. Pastaj kemi diskutimet dhe votimi do të bëhet ashtu siç do të bëjmë edhe votimin e tri ligjeve në tërësi.

Po, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Siç e vlerësuat edhe ju, për shkak të miratimit të ligjit nr. 119 të vitit 2014 “Për të drejtën e informimit” ka lindur domosdoshmëria për rishikimin e strukturës së Komisionerit që tashmë quhet për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke qenë se ligji ka hyrë në fuqi në fillim të muajit nëntor, për t’u paraprirë procedurave të nevojshme nga ana jonë është prezantuar projektstruktura, menjëherë me botimin e ligjit në Fletoren Zyrtare, duke ia dërguar atë për vlerësim edhe Departamentit të Administratës Publike, si edhe Ministrisë së Financave. Kjo është një strukturë në të cilën është integruar detyrimi që buron nga ligji për ngritjen e një strukture për të drejtën për informim, pra është krijuar një drejtori e re, e cila do të mbulojë të gjitha detyrimet dhe funksionet që ngarkohen nga ky ligj.

Për sa i përket pjesës tjetër të strukturës në përgjithësi ne kemi ruajtur kolonën e mbrojtjes së të dhënave personale, ku do të trajtohen detyrimet që burojnë nga ligji nr. 987 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke forcuar më tej sektorin e Hetimit Administrativ si një

pjesë mjaft e rëndësishme, e cila për hir të së vërtetës deri në periudhën aktuale nuk është ndjerë në nivelin e kërkuar.

Riorganizohet Drejtoria Juridike duke përcaktuar më qartë detyrat e saj dhe duke përcaktuar detyrat e Sektorit të Legjislacionit për shkak se është detyrim i nenit 31 të ligjit nr.9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, konsultimi i të gjitha institucioneve që propozojnë akte ligjore ose nënligjore me zyrën e Komisionerit për çështje të cilat trajtojnë të dhëna personale.

Për sa i përket drejtorisë tjetër, është një drejtori ku ne kemi integruar marrëdhëniet ndërkombëtare me marrëdhëniet me publikun, do të specializohet edhe një specialist që do të mbajë në mënyrë të veçantë marrëdhëniet me mediat, si një nga sektorët më sensibil të përpunimit, jo vetëm të të dhënave personale, por edhe për të drejtën e informimit.

Në drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme kemi shkurtuar një punonjës mbështetës dhe e kemi zëvendësuar me një specialist të IT-së, sepse sektori i IT-së që ekzistonte në strukturën e vjetër integrohet në grupin e inspektorëve. Për grupet e inspektimit është e nevojshme të jenë të përbërë nga një inspektor jurist dhe nga një inspektor i IT-së për vetë veçorinë e punës.

Nga pikëpamja procedurale kjo projektstrukturë është dërguar si në Departamentin e Administratës Publike, ashtu edhe në Ministrinë e Financave. DAP-i është shprehur dakord, ka pasur vetëm një problem teknik për sa i përket kategorizimit të pagës së inspektorëve, e cila është zgjidhur me vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.805, datë 26.11.2014 ku edhe inspektorët e zyrës së Komisionerit barazohen me inspektorët e institucioneve të tjera që kryejnë hetim administrativ.

Ministria e Financave në përgjigjen e saj është shprehur për përshtatjen e numrit të punonjësve. Për shkak se struktura jonë ka qenë mbi numrin e punonjësve të parashikuar në ligjin “Për buxhetin e vitit 2014” ka sugjeruar që struktura të miratohet pasi të përcaktohet numri i punonjësve në buxhetin e vitit 2015. Duke qenë se numri i punonjësve të parashikuar në ligjin e buxhetit për vitin 2015 është 35, edhe ne kemi modifikuar strukturën me 35 punonjës. Është varianti që ju keni, i modifikuar, pra duke shkurtuar një këshilltar. Në kabinetin e Komisionerit ishin parashikuar dy këshilltarë, ku njëri do të ishte për të drejtën e informimit dhe tjetri për mbrojtjen e të dhënave personale, por natyrisht do ta mbulojmë punën me një këshilltar. Është

më mirë të kemi një inspektor, të paktën unë kështu e kam gjykuar, që të mos cenojmë drejtoritë që merren me punën konkrete, me punën e drejtpërdrejtë dhe ta shkurtojmë këtë nga kabineti.

Kaq kisha shkurtimisht. Jam i hapur për çdo pyetje dhe sugjerim tuajin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Dervishi!

Ka pyetje? Nuk ka.

Mund ta kenë sqaruar edhe këta të Njesisë së Monitorimit, por e kam merak çështjen nëse është reflektuar në buxhet vërejtja që ka bërë ministri i Financave, sepse ai ka shprehur një rezervë. Shkresa është e muajit nëntor. A është e pasqyruar kjo me këtë detyrimin?

Po, urdhëroni!

Vilma Çausholli – Faleminderit!

Në fakt, ne nuk e disponojmë strukturën e paraqitur të ripunuar brenda numrit, por në një komunikim paraprak që bëmë tani rezulton se është paraqitur me 35 punonjës. Kaq është i miratuar në ligj, por edhe fondet për shtesën e numrit të punonjësve janë parashikuar në ligjin e buxhetit, vetëm unë do të sillja në vëmendje që efektet financiare të kësaj projektstrukture të fillojnë më 1 janar të vitit 2015, atëherë kur bëhet efektiv edhe ligji i buxhetit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jemi më të qartë për këtë gjë.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Po, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – E falënderoj shumë zotin Fino për sensibilitetin!

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po.

Bashkim Fino – ...të flisja, se nuk doja të të bëja qejfin ty të të jepja një tepër, por ka një problem shumë të madh...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u mërzitni! Ndonjëri që thotë: “Obobo!”, mund të ikë, por atë që kemi votuar një herë, nuk kemi pse e bëjmë tani. Kemi votuar buxhetin, ishe relator dhe ke miratuar 36 veta për këtë çështje. Tani, pasi ka miratuar buxhetin, nuk mund të vijë sot që të miratojmë strukturën

(është një porosi e lënë nga kryetari i komisionit që të gjitha institucionet e pavarura duhet të kalojnë strukturat këtu, se nuk i kanë kaluar) dhe ministri i Financave të na thotë: “Jo, do të miratohen 35”. Po çfarë jemi ne që kemi kaluar 36? Kjo është e gjitha.

Në qoftë se ju e quani jokorrekt votimin që keni bërë herën e kaluar dhe mund ta dridhni prapë e të thoni: “Nuk ka problem se është 35”, bëjeni. Unë nuk e bëj dot këtë gjë. Unë kam votuar për 36.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Natyrisht, 36 do të ishin më mirë sesa 35, por me Ministrinë e Financave dhe me Departamentin e Administratës Publike kemi lënë një diskutim të hapur, sepse ndërkohë është miratuar edhe ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili i ngarkon përsëri detyra të tjera Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por që nuk ka hyrë ende në fuqi. Ndërkohë, ne kemi fituar një projekt me fondacionin “Soros” dhe një punonjës për të drejtën e informimit, që do të luajë rolin e koordinatorit të projektit dhe është një rol mjaft i rëndësishëm që do të merret ekskluzivisht njëlloj si Drejtoria për të Drejtën e Informimit. Kështu që edhe për vitin 2015 ne jemi të mbuluar fiks sipas nevojave tona. Natyrisht, këtu do të jemi. Në qoftë se do të kemi nevoja të tjera, do t’i paraqesim dhe besoj se angazhimi juaj si deri tani do të jetë maksimal.

(Diskutime në sallë.)

Bashkim Fino – Ky mund të jetë i kënaqur edhe me 30 dhe vërtet nuk arrij ta kuptoj, por unë e shoh në një prizëm tjetër, në prizmin e relatorit të komisionit për buxhetin e shtetit që ne kemi miratuar 36, kurse ministri i Financave thotë 35. Ky thotë: “Nuk ka problem, unë mbaj edhe 34”. Le të mbajë sa të dojë ai, por nuk është pronë e tij, është e institucionit tonë. E kupton? Ky është thelbi i diskutimit që bëra unë dhe që e keni votuar edhe ju, kolegë të nderuar, keni votuar për 36 veta. Tani, sot do të votoni për 35. Pse? Sepse thotë një ministër. Po si ka mundësi që kur ne votojmë në parlament 140 burra atje, zoti ministër dhe ju të ktheni votën? Ky është thelbi i të gjithë diskutimit që bëj.

(Diskutime në sallë.)

Besnik Dervishi – Ky ka qenë thelbi i diskutimit, sepse natyrisht mua më duhen njerëz edhe për t’i kultivuar si për të drejtën e informimit, ashtu edhe për mbrojtjen e të dhënave personale, por duke qenë se në aneksin bashkëlidhur projektligjit të buxhetit është lënë një

rezervë prej 85 personash, ky ka qenë edhe diskutimi që me hyrjen në fuqi të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” do të shikohet mundësia edhe për plotësimin e kësaj nevojë.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Duke qenë se është ligj, unë i nënshtrohem numrit 35, pavarësisht se propozimi im vetë ka qenë për 36, por i nënshtrohem vetë vullnetit të ligjit.

Faleminderit!

(Mungesë regjistrimi.)

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me Kodin Penal.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Më falni!

Pra, miratuam projektvendimin “Për miratimin e strukturës organike të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit” me një votë kundër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Dashamir Peza, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

HAPET MBLEDHJA

Votuam Kodin Penal në tërësi dhe jemi të gjithë dakord me ndryshimet e miratuara.

Tani do të votojmë në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar. U shqyrtua nen për nen. Janë bërë ndryshimet kur u miratuan nen për nen.

Me ndryshimet e miratuara kemi votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” me ndryshimet e bëra nen për nen të nismës së paraqitur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.12.2014, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Dashamir Peza, Tom Doshi, Silva Caka Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka, Tahir Muhedini dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu dhe Arben Ristani.

HAPET MBLEDHJA

Vazhdojmë me votimin tjetër, për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Bashkimi i dy nismave të ardhura në një tekst integral, që u shqyrtua nen për nen, me ndryshimet e shtesat e bëra edhe gjatë debatit në komision...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jemi në proces votimi. Po, urdhëroni.

Dashamir Peza – A janë përfshirë vërejtjet tona që i bëmë dje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Edhe në përgjigje të kësaj, me ndryshimet dhe shtesat e bëra gjatë debatit, diskutimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për çfarë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi lënë në ligj. Më vjen keq! E kemi lënë dje dhe e kemi votuar. Nuk ka kthim mbrapa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem! Nuk ka...

Bashkim Fino – Ju lutem unë juve! Dha një sqarim relatorja, e cila... *(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Fatmir Xhafaj – Pse? Më falni, një minutë! As relatorja, as ju dhe askush tjetër nuk mund të diskutojë kur është në proces votimi një gjë që është votuar dje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është votuar dhe unë votoj në tërësi, nuk votoj për gjë tjetër. Pastaj, po të dojë dikush...

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Më vjen keq, është në material! E kam unë këtu përpara dhe unë kam votuar, zotëri, madje edhe e kam theksuar se është shtuar edhe Avokatura e Shtetit.

Më vjen keq se si, nga... Se ku kam qenë unë këtu?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam këtu. Ma jepni një material. Më vjen keq, ja ku e keni këtë!

Vasilika Hysi – Është te faqja e parë.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk është serioze, po hajde po e bëj: “Punonjësve që realizojnë atributet e agjentit, oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ata që sipas ligjit lejohen të mbajnë armë: a) civilët në Forcat e Armatosura, b) punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, c) Bordet e Kullimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit dhe d) Avokatura e Shtetit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Peza, ju lutem shumë, ndiqeni këtë gjatë seancës!

Kur unë e kam kaluar, e kam kaluar. Unë e kam lexuar, si qenka kështu?

(Deputeti Peza ndërhyr pa mikrofon.)

Dakord, po e pate votuar, votoje në tërësi. Mos më bëj mua tani sikur... çfarë të them unë.

Më vjen keq! Kam qenë dje korrekt, sot korrekt. Atje kur nuk miratohet, nuk miratohet. Unë do ta thosha: nuk miratohet. Pse e vini në diskutim? Pastaj, le të ngrihet po të dojë dikush...

(Deputeti Peza ndërhyr pa mikrofon.)

Dashamir Peza – Kjo është shkelje e hapur e votimit. Ndryshon.

Fatmir Xhafaj – Po si ndryshon? Derisa është lexuar dje këtu, u lexua edhe sot këtu, si do të ndryshojë? Unë nuk e kuptoj dot si mund të ndryshojë. Kush mund ta ndryshojë, zotëri? Ç’e keni këtë gjë?

Procedurë është kjo që bëj unë, jo ajo që thoni ju dhe kushdo tjetër.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për nëpunësin civil” me tekstin e integruar, me ndryshimet dhe shtesat e bëra edhe gjatë debatit dje dhe sot? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. Miratohen të gjitha sipas asaj që u lexua më lart.

E mbyllim këtu mbledhjen. Faleminderit! Ditë të mbarë! Mirupafshim!

MBLEDHJA MBYLLET

